



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 42

Tiranë – E mërkurë, 17 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 29/2021, datë 8.3.2021	Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”..... 4991
Dekret i Presidentit nr. 12015, datë 11.3.2021	Për shpallje ligji..... 4992
Dekret i Presidentit nr. 12013, datë 10.3.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4992
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 26.2.2021	Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural..... 4992
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 16.2.2021	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm..... 5035
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 16.2.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. (79) 48, datë 29.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. 81, datë 28.3.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2018-240, datë 12.7.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 5037
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Rabije Hoti..... 5044



LIGJ
Nr. 29/2021

**PËR ZHVILLIMIN DHE
PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
VENDEVE ANËTARE TË
ORGANIZATËS SË TRAKTATIT TË
ATLANTIKUT TË VERIUT DHE TË
VENDEVE PARTNERE TË KËSAJ
ORGANIZATE NË STËRVITJEN E
PËRBASHKËT “DEFENDER
EUROPE 21”**

Në mbështetje të neneve 12, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Zhvillimin dhe pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate (në vijim, trupa aleate) në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”.

Neni 2

Lejimin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të 3100 (tre mijë e njëqind) trupave aleate, pjesëmarrëse në stërvitje.

Neni 3

Qëllimi i pjesëmarrjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në paketën e stërvitjeve “Defender Europe 21” është demonstrimi i aftësive të Forcave të Armatosura për të pritur, koordinuar dhe për t’u stërvitur e trajnuar me forcat amerikane dhe të NATO-s në aktivitete/operacione të përbashkëta, në një ambient operacional kompleks, në poligone e terrene stërvitore.

Neni 4

Stërvitja “Defender Europe 21” zhvillohet në periudhën 26 prill – 20 qershor 2021 në

Komandat e Forcave Tokësore, Ajrore dhe Detare, në garnizonin “Skënderbej”, në bazën ajrore të Farkës, në bazën ajrore të Kuçovës dhe në poligonet stërvitore të Bizës e Fekenit, si dhe në rrugëkalimet ajrore e tokësore për në këto rajone.

Neni 5

Në këtë stërvitje angazhohen 3100 (tre mijë e njëqind) trupa aleate, 10 (dhjetë) anije, 18 (tetëmbëdhjetë) avionë, 19 (nëntëmbëdhjetë) helikopterë, 6 (gjashtë) sisteme raketash patriot dhe 1000 (një mijë) automjete joluftarake, të cilat kryejnë lëvizje gjatë 24 (njëzet e katër) orëve në rajonin e përcaktuar të stërvitjes, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 6

Trupat e vendeve aleate gjatë hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë kanë statusin e parashikuar në marrëveshjen ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave të tyre, nënshkruar në Londër, më 19.6.1951, dhe të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 10 101, datë 26.3.2009.

Neni 7

Gjatë hyrjes, qëndrimit e daljes nga territori i Republikës së Shqipërisë, trupat e vendeve aleate shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm dhe ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.3.2021.

**Shpallur me dekretin nr. 12015, datë 11.3.2021
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

**DEKRET****Nr. 12015, datë 11.3.2021****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 29/2021 “Për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave të vendeve anëtare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe të vendeve partnere të kësaj organizate në stërvitjen e përbashkët “Defender Europe 21”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 12013, datë 10.3.2021****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës; si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Sheqir Isa Podvorica
2. Zamir Halim Sylejmani
3. Rajmonda Rexhep Lika (Rizahu)
4. Luljeta Abdurrahman Kavaja (Nushi)
5. Lee Alden Vernon Leonard Church
6. Kathryn George Peter Church (Stathas)
7. Valona Sefer Ponik (Driza)
8. Arbnorë Elez Sallahu

9. Mejdai Faiuk Tafaj
10. Petrit Osman Krasniqi
11. Seher Muammer Sarikaya (Doğru)
12. Amgad (Amxhed) Mohamed Fathalla (Fethallah) Ahmed Youssef

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM**Nr. 9, datë 26.2.2021****PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË
FONDIT TË PROGRAMIT PËR
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; të ligjit nr. 137/2021, “Për buxhetin e vitit 2021”; të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1102, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për vitin 2021”,

UDHËZOJMË:**I. PËRDORIMI I FONDIT TË
PROGRAMIT PËR BUIQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL**

Fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021, zëri “Transferte në buxhetet familjare” (Llogaria ekonomike 606), të përdoret për masat mbështetëse, si më poshtë vijon:



Nr. i masës	Emërtimi i masës
1	Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt, ndërsa për fermat me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.
2	Mbarëshitim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.
3	Zëvendësimi i plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën respektive 300 000 (treqind mijë) lekë/ha dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt. Sipërfaqja e serrës apo e tunelit plastik të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.
4	Mbjellje bimësh mjekësore e aromatike në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për fermerët individualë dhe për grup-fermerësh, ndërsa për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (në vijim “SHBB”), jo më shumë se 4 000 000 (katër milion) lekë. Sipërfaqja e mbjellë për fermerët individualë duhet të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, për grup-fermerësh, jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm, për SHBB-të, jo më pak se 5 (pesë) ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, kur nuk është në bllok.
5	Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.
6	Implementimi dhe certifikimi Global GAP në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha.
7	Mbështetje për linja/makineri/pajisje për përpunimin, paketimin, standardizimin dhe etiketimin e ullirit, vajit të ullirit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milion) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.
8	Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milion) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.
9	Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milion) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilat nuk mund të mbështeten nga programi IPARD II.

II. KUPTIMI I SHKURTIMEVE

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (agjencia e pagesave)
AREB	Agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor
ARSHVMB	Agjencitë rajonale të shërbimit veterinar dhe të mbrojtjes së bimëve
DVASHT	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, AZHBR
DPAP	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve
DK	Drejtoria e Kontrollit, AZHBR
ESHFF	Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
DAP	Drejtoria e Autorizimit të Pagesave në AZHBR
DEP	Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave në AZHBR
DAMT	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark
SPAP	Spektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve në AZHBR
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
NIPT	Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm
NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
SHBB	Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit



III. KRITERE TË PËRGJITHSHME TË PËRFITIMIT

1. Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar ose person juridik ku të paktën njëri prej ortakëve/aksionarëve është shtetas shqiptar.

2. Përfitues sipas masave mbështetëse mund të jenë fermerë individualë, grup-fermerësh, subjekte me status fizik, juridik, SHBB.

3. Fermerët individualë të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit me status aktiv.

4. SHBB-të dhe personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS me status aktiv.

5. Përfituesi të këtë bërë “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”.

Aplikanti, për masat mbështetëse direkte me nr. 1–6, në rast se rezultojnë që nuk e ka realizuar “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore” në momentin e aplikimit, duhet të paraqesë pranë agropikës më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së, vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve. Lista e agropikave jepet në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Për investimet, ofertat/faturat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e hapjes së aplikimit.

7. Faturat/aktet e zhdoganimit, për masat mbështetëse direkte, në përputhje me kriteret përkatëse, duhet të jenë të lëshuara gjatë vitit 2021.

8. Për masën mbështetëse të investimeve, punimet, faturat/aktet e zhdoganimit, dhe transaksionet bankare duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës.

9. Të gjitha materialet/pajisjet të jenë të reja.

10. Për masat mbështetëse të investimeve, në rastin e ndërtimeve/rikonstruksioneve, duhet të sigurohet leja përkatëse e ndërtimit në varësi të investimit (leje ndërtimi/rikonstruksioni, miratim i deklaratës paraprake), sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve. Dorëzimi i këtij dokumenti pas afatit të përcaktuar është element skualifikimi.

11. Financimi i shumës së përfutur bëhet në bankat e nivelit të dytë.

12. I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar dhe i vërtetuar nga noteri.

13. Aplikanti mund të aplikojë dhe përfutojë vetëm në njërin nga masat mbështetëse. Për masën mbështetëse nr. 1, aplikanti mund të aplikojë dhe përfutojë për të tria speciet e kafshëve.

Kriteret e përcaktuara në pikat 1–5, të këtij kreu, vërtetohen nga sistemi *e-Albania* ose nga burime të tjera zyrtare.

IV. APLIKIMI

Informacioni i nevojshëm për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe të procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë agropikave, pranë agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor, zyrave qendrore të AZHBR-së, si dhe në faqen e saj të internetit: www.azhbr.gov.al.

Aplikimet për të gjitha masat do të bëhen nga data 24.3.2021 deri më 15.4.2021.

Aplikimi *online* është i mundshëm përgjatë 24 orëve, nga ora 00:01 e datës së hapjes deri në orën 24:00, të datës së përfundimit të periudhës së aplikimit.

1. Aplikimi *online*

a) Aplikimet për masat mbështetëse direkte me nr. 1–6 do të bëhet *online*.

b) Aplikimi *online* bëhet mbi bazën e parimit “zero dokumente” në momentin e aplikimit.

c) Aplikimi *online* do të bëhet nga aplikanti në portalin *e-Albania*. Aplikantët kur e kanë të nevojshme gjatë procesit të aplikimit asistohen *online*, nëpërmjet numrit jeshil 08008383, nga specialistët e agropikave, agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor, si dhe shërbimit *online* (*call center*) nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

d) Përfitues për masat mbështetëse të mësipërme mund të jenë fermerë individualë, grup-fermerësh, persona fizikë, juridikë, SHBB.

e) Aplikimi *online* është i mundshëm përgjatë 24-orëve nga data e hapjes deri në përfundim të periudhës së aplikimit.

f) Procedura e aplikimit nga portali *e-Albania* përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

Renditja e aplikimeve bëhet automatikisht nga sistemi në rang kombëtar dhe për çdo masë mbështetëse.

2. Aplikimi me dosje në AZHBR

a) Aplikimet për masën mbështetëse të investimeve me nr. 7–9 do të bëhen me dosje në zyrat qendrore të AZHBR-së.



b) Për qëllime identifikimi, aplikanti, sipas statusit përkatës (person fizik/juridik) ose përfaqësuesi i tij me prokurë ose autorizim, duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me letërnjoftim elektronik ose pasaportë biometrike.

V. DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ZYRTARË DHE PLATFORMA e-ALBANIA

1. Formulari i aplikimit për masën mbështetëse përkatëse;

2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit;

3. Dokumenti që vërteton statusin e aplikantit (fermer, person fizik/juridik “SHBB”);

4. Konfirmimi që aplikanti (ortakët, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e SHBB-së) nuk janë debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së apo tatimeve;

5. Dokumenti për “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”;

6. Leje apo licenca për masat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

7. Regjistri elektronik i blegtorisë (RUDA) dhe bletarisë.

Aplikantët për masat 1–6, që janë mbi vijën e financimit, për të cilët ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë apo nuk plotësojnë kriteret e përfitueshmërisë, informohen nëpërmjet listës së aplikimeve të kualifikuara, ndërsa aplikantët për masat 7–9 njoftohen me shkresë për plotësim dokumentacioni.

Dorëzimi i dokumentacionit, për masat direkte 1–6, bëhet në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së, ndërsa për masat 7–9 bëhet në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me Postë në zyrat qendrore të AZHBR-së.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 15 ditë kalendarike pas publikimit së listës së aplikantëve të kualifikuar, në faqen zyrtare www.azhbr.gov.al.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë, brenda afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.

VI. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE 1–6

MASA 1. Për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermat me jo më pak se 70 (shtatëdhjetë) krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1 200 (një mijë e dyqind) lekë/krerë, por jo më shumë se 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë për subjekt,

ndërsa për fermat me jo më pak se 5 (pesë) krerë lopë, në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikanti duhet të ketë në tufën bazë jo më pak se 70 krerë dele dhe/ose dhi, dhe/ose jo më pak se 5 krerë lopë, të matrikulluara;

c) Kafshët e tufës bazë duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të kafshëve – RUDA;

d) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe tatimeve.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda 15 ditë kalendarike pas publikimit së vijës së financimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

MASA 2. Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje, por jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.

i) Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik.

e) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

f) Aplikanti, në momentin e verifikimit të ketë jo më shumë se 1 vendndodhje për 50 koshere të bletëve, jo më shumë se 2 vendndodhje për 100 koshere dhe jo më shumë se 3 vendndodhje për 150 koshere;



g) Kosheret e bletëve të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrin elektronik të ARSHVMB-ve përkatëse;

h) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe tatimeve.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda 15 ditë kalendarike pas publikimit së vijës së financimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

Fotokopje ose vërtetim i dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

MASA 3. Zëvendësimi i plastmasës termike për serrat diellore ekzistuese për prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë dhe tunelet plastike për prodhimin e luleshtrydhes në vlerën respektive 300 000 (treqind mijë) lekë/ha dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë për subjekt.

Sipërfaqja e serrës apo e tunelit plastik të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha.

i. Kriteret specifike për masën

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikantë të kësaj mase janë fermerë, të cilët kanë serra diellore me plastmasë me destinacion prodhimin e perimeve, rrushit për tavolinë, si dhe tunele plastike për prodhim luleshtrydhe;

c) Aplikanti për këtë masë mbështetjeje mund të përfitojë financim, nëse në 3 vitet e fundit nuk ka përfituar për zëvendësim plastmase, për të njëjtën serrë apo tunel;

d) Plastmasa të jetë termike, e tipit *long life*, e vërtetuar me certifikatën e garancisë;

e) Aplikanti të ketë plan-vendosjen e serrës për zëvendësimin e plastmasës apo të tunelit, me të dhënat kryesore;

f) Toka të jetë në pronësi të aplikantit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet, përfshirë edhe vitin e aplikimit.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

a) Plan-vendosjen e serrës/tunelit plastik me të dhënat kryesore, për të cilën kërkohet të zëvendësohet plastmasa, sipas aneksit 3.

b) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo të marrjes me qira

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësi administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet duke përfshirë edhe vitin e aplikimit;

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda 15 ditë kalendarike pas publikimit së vijës së financimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a) Fatura/faturat tatimore të blerjes së plastmasës, të shoqëruar me certifikatën e garancisë;

b) Aktzhdoganimin, për rastet kur plastmasa vjen nga jashtë vendit, shoqëruar me certifikatën e garancisë;

c) Faturat e mësipërme duhet të jenë të shoqëruara me kuponin e kasës fiskale ose mandatpagesën e bankës;

d) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.



Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

MASA 4. Mbjellje bimësh mjekësore e aromatike në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë/ha, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë për fermerët individualë dhe për grup-fermerësh, ndërsa për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (në vijim “SHBB”), jo më shumë se 4 000 000 (katër milionë) lekë.

Sipërfaqja e mbjellë për fermerët individualë duhet të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, për grup-fermerësh, jo më pak se 1 ha në një bllok të vetëm, për SHBB-të, jo më pak se 5 (pesë) ha. Madhësia e ngastrës të jetë jo më pak se 0.2 (zero pikë dy) ha, kur nuk është në bllok.

i. Kriteret specifike për masën

Përfituesi të mundshëm: Fermerë individualë, grup-fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Sipërfaqja e mbjellë të jetë, sipas kategorive të mëposhtme:

- për fermerët individualë jo më pak se 0.2 ha;
- për grup-fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm;
- për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) jo më pak se 5 ha, ndërsa madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.2 ha, kur nuk është në bllok;

b) Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë i certifikuar dhe i regjistruar në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve, sipas aneksit 4;

c) Toka të jetë në pronësi të aplikuesit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet përfshirë edhe vitin e aplikimit;

d) Të realizojnë mbjelljet brenda periudhës 30 shtator 2021. Faturat e blerjes së materialit mbjellës duhet të përputhen me periudhën e realizimit të mbjelljeve;

e) Të mos ketë përfituar mbështetje financiare në vitin 2020 për mbjellje bimësh mjekësore e aromatike shumëvjeçare në parcelën/parcelat që aplikon;

f) Aplikanti të ketë formularin për mbjelljen e bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara, sipas aneksit 5.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

a) Marrëveshje e dakordësisë së anëtarëve të grup-fermerëve, SHBB-ve apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon.

b) Formularin për mbjelljen e bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara, sipas aneksit 5.

c) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo të marrjes me qira.

Pronësia mbi tokën bujqësore vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme.

2. Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësia administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin e aplikimit.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve, brenda 15 ditë kalendarike pas publikimit së vijës së finacimit.

iii) Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a) Për farat dhe fidanët e prodhuar në vend:

- faturë tatimore e blerjes së fidanëve/farave, lëshuar nga subjekti tregtues, ku specifikohet lloji dhe sasia e farave/fidanëve të blerë.

- një fotokopje të certifikatës zyrtare për materialin mbjellës (lëshuar nga ESHFF-ja), nga subjekti i certifikuar me nënshkrim e vulë të njomë të subjektit tregtues.

b) Për materialin mbjellës të importuar (farat dhe fidanët):

- faturën tatimore të blerjes lëshuar nga subjekti tregtues ose aktin e zhdoganimit, ku specifikohet



specia, kultivari dhe sasia e materialit mbjellës të blerë;

- fotokopje të certifikatës së origjinës/certifikatës fitosanitare/certifikatës nga AKU-ja, të vërtetuar me origjinalen me nënshkrimin dhe vulën e njomë të subjektit tregtues.

c) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

Masa 5. Fermat organike, për periudhën në kalim, vitin e parë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë, 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar.

i. Kritere specifike të përfitimit

Përfitues të mundshëm: Fermerë individualë, SHBB, grup-fermerësh, person fizik ose juridik.

a) Përfitojnë të gjithë aplikuesit që janë në sistem/skeme certifikimi, në kalim (viti parë dhe/ose viti i dytë) ose në certifikim, me kusht që sipërfaqja e mbjellë që certifikohet të mos jetë më e vogël se 0.5 ha.

b) Toka të jetë në pronësi të aplikuesit, në përdorim ose me qira për të paktën 5 vjet, përfshirë edhe vitin e aplikimit.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

a) Kontrata e lidhur nga aplikuesi me një trupë kontrolli të miratuar në MBZHR-ja për specien/speciet dhe sipërfaqen e kultivuar.

b) Dokumenti i dakordësisë së anëtarëve të grup-fermerëve, SHBB-ve apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon.

c) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo të marrjes me qira.

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme.

2. Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore,

bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësi administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin e aplikimit.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda 15 ditë kalendarike pas publikimit së vijës së financimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a) Dokumentet e certifikimit (certifikatë për statusin e certifikimit, anekset e certifikatës, listën e parcelave me sipërfaqe dhe sasinë e prodhimeve) lëshuar nga një trupë kontrolli e miratuar nga MBZHR-ja.

b) Faturë tatimore me TVSH ose faturë e thjeshtë A4 e shoqëruar me kupon tatimor të trupës certifikuese/ose *invoice*, kur nuk është kompani shqiptare.

c) Transferte e bankës të subjektit që është certifikuar me vlerën e shërbimit.

d) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

Masa 6. Implementimi dhe certifikimi *Global GAP* në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore, por jo më shumë 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, në perime, fruta, rrush, ullinj dhe agrume, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha.

**i. Kriteret specifike të përfitimit**

a) **Përfitues të mundshëm:** Fermerë individualë, grup-fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik.

Një aplikues mund të përfitojë një certifikatë, e cila mund të përmbajë më shumë se një produkt, në sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për një ose më shumë kultura të mbjella.

b) Aplikuesi duhet të jetë në procedurë certifikimi me një trupë certifikimi të akredituar (shqiptare ose e huaj).

c) Certifikata të ketë elemente të verifikueshme *online*, për operatorin, trupën e certifikimit dhe organizmin akreditues në faqen zyrtare të *Global GAP*.

d) Aplikuesit të ndjekin procedurën e miratuar deri në marrjen e certifikatës *Global GAP*.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

a) Kontrata e lidhur nga aplikuesi me trupën e certifikimit të akredituar;

b) Dokumenti i dakordësisë së anëtarëve të grup-fermerëve, SHBB-ve apo ortakëve të subjektit para noterit, për produktin që aplikon;

c) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo të marrjes me qira.

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;

2. Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësia administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore;

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin e aplikimit.

Aplikanti të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda 15 ditëve kalendarike pas publikimit së vijës së financimit.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a) Certifikatë, fotokopje e noterizuar dhe në gjuhën shqipe, që vërteton sasinë e prodhimit të certifikuar si *Global GAP* për herë të parë, të lëshuar nga trupa e certifikimit e akredituar;

b) Faturë tatimore për kostot e procesit të implementimit;

c) Faturë tatimore nga trupa e certifikimit e akredituar/ose *invoice*, kur trupa e certifikimit nuk është kompani shqiptare;

d) Transferten e bankës/kuponi tatimor për faturat e mësipërme nga subjekti që është certifikuar;

e) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

Në rastet kur dokumenti për numrin e llogarisë bankare nuk është dorëzuar edhe në momentin e verifikimit, aplikantit mund ta dorëzojë atë në agropikën më të afërt, brenda 15 ditësh kalendarike nga data e verifikimit në terren. Ky dokument skanohet e ngarkohet në sistem.

APLIKIMI PËR MASAT 1–6

Aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor kryen regjistrimin në portalin *e-Albania* me kartën e identitetit. Pas regjistrimit, aplikantit i shfaqet në sistem dritarja “Aplikim për skemat kombëtare”. Aplikanti plotëson NIPT-in e fermerit, përzgjedh masën mbështetëse dhe plotëson (vetëdeklaron) sasinë që ka (krerë, sipërfaqe) dhe jep komandën “dërgo”.

Rubrikat që shfaqen në sistem janë:

1. Masa mbështetëse;
2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit (në rast kur ka përfaqësues, të dhënat në formular të jenë ato të aplikantit);
3. Statusi, nëse aplikanti ka NIPT aktiv;
4. Vendndodhje e aplikimit;
5. Sasia e aplikuar (krerë/koshere/sipërfaqja në ha);
6. Vlera e aplikimit;
7. Numër kontakti;
8. Konfirmimi për raste, kur aplikanti është i regjistruar në QKB, nuk është debitor ndaj drejtorisë së tatimeve;
9. Të dhëna për sigurimet shoqërore koherente, nëse janë paguar në momentin e aplikimit;



10. Kodi i aplikimit dhe koha e regjistrimit në sistem, të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi;

11. Aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve, sipas ligjeve në fuqi;

12. Aplikanti informohet se nuk mund të përfitojë nëse është debitor ndaj AZHBR-së dhe/ose MBZHR-së dhe/ose nuk ka derdhur detyrimet koherente për sigurimet shoqërore.

Procedura e aplikimit përfundon me mesazhin në sistem “Aplikimi u regjistrua me sukses”.

VII. PROCEDURA QË DO TË NDIQET PËR PËRZGJEDHJEN, VERIFIKIMIN DHE PAGESAT PËR MASAT MBËSHTETËSE ME NR. 1–6

1. Përveç sa përcaktohet në kreun IV – Aplikimi *online*, aplikimi për masën mbështetëse 1 bëhet mbi bazën e numrit të deleve dhe/ose të dhive, si dhe dhe/ose lopëve të tufës bazë ekzistuese, përfshirë edhe kafshët riprodhuese meshkuj, të vërtetuar nga sistemi RUDA. Financimi për masën 1 do të bëhet sipas numrit faktik të tufës bazë, në momentin e verifikimit.

2. Me përfundimin e fazës së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikantëve për çdo masë mbështetëse, sipas parimit “Kush vjen i pari renditet i pari”.

3. Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen *online*, AZHBR-ja shpall brenda 15 ditëve kalendarike, listën e aplikimeve të kualifikuara me vizën e financimit dhe dokumentet e kërkuara, sipas masës përkatëse, në faqen zyrtare të saj: www.azhbr.gov.al.

4. Të gjithë aplikantët mbi vijën e financimit, sipas evidencimeve në listën e shpallur, kanë afat deri në 15 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve, të dorëzojnë dokumentet e kërkuar në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së.

5. Inspektori/specialisti i agropikës, për çdo dokument të paraqitur nga aplikanti/përfaqësuesi ligjor apo çdo dokument tjetër të gjeneruar nga regjistrat publikë, mban procesverbal në dy kopje, të marrjes në dorëzim të dokumenteve dhe i dërgon në AZHBR, Tiranë.

6. Dosja origjinale transferohet nga zyrat e aplikimit në AZHBR përmes protokollit në sektorin e SPAP-së/AZHBR-së.

7. DPAP-ja/SPAP-ja bën kontrollin administrativ të dokumentacionit, si të atyre që gjenerohen nga sistemi *online* dhe të atyre që ndodhen në dosjen e aplikimit dhe në përputhje me kriteret, aprovon/skualifikon aplikimet përkatëse.

8. Grupi i verifikimit, në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit, sipas masës përkatëse. Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe i gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti/përfaqësuesi ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë.

9. Kur grupi i verifikimit ka mendime të ndryshme, në lidhje me gjetjet faktike në terren, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit të AZHBR-së qendër, bën rivefikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i pakontestueshëm administrativisht nga palët.

10. Para pagesës, në momentin e verifikimit, të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik dhe juridik, që kryejnë aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, duhet të plotësojnë formularin e regjistrimit të fermës, sipas aneksit 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Në momentin e verifikimit aplikanti/përfaqësuesi ligjor i dorëzon grupit të verifikimit dokumentet e nevojshme të parashikuara në këtë udhëzim.

12. Procedurat e funksionimit të procesit të aplikimit dhe të verifikimeve përcaktohen në Manualin e Procedurave të Implementimit të Skemave Kombëtare 2021.

Në këtë manual, brenda 10 ditëve pune nga përfundimi i aplikimeve, përcaktohen edhe afatet konkrete për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve, shpalljen e listës përfundimtare të fituesve dhe kohën e disbursimit të fondeve te fermerët.

Lëvizja e vizës së financimit

Nëse nga “Kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren” rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR-ja për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit me fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës, të cilët shpallen në faqen zyrtare të saj: www.azhbr.gov.al dhe në agropika.



Këta aplikantë kanë afat 15 ditë kalendarike për të dorëzuar dokumentet që mungojnë sipas listës së publikuar.

Për aplikimet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR-ja shpall në faqen zyrtare të internetit listën e subjekteve të skualifikuar me arsyet e skualifikimit.

VIII. KRITERET, APLIKIMI DHE DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR MASËN 7-9

Aplikimet për mbështetje financiare për këto masa dorëzohen në AZHBR-qendër, adresa: rruga “Muhamet Gjollesha”, nr. 56. Dokumentacioni i dorëzuar firmoset /vulohet dhe dorëzohet në një zarf të mbyllur. Në zarf shkruhet: Masa e mbështetjes, emri i aplikantit/i subjektit dhe adresa.

Shpenzime të papranueshme për masat 7-9:

- blerje e truallit apo ndërtesës;
- shpenzime operative si transporti i makinerive dhe linjave të ndryshme, elektriciteti, uji, gaz, mirëmbajtje, amortizim dhe kostot e qirasë, etj.
- detyrimet doganore dhe të importit ose çdo tarifë që ka efekt të njëjtë;
- blerje, qira ose *lizing* për tokën apo për ndërtesat ekzistuese;
- gjopa apo detyrime gjyqësore;
- kostot operative të aktivitetit;
- makineri dhe pajisje të përdorura;
- detyrime bankare, si kosto garancish e të tjera të ngjashme;
- kontributet në natyrë;
- kosto të shkëmbimit valutor;
- shpenzime të kryera në objekt para lidhjes së kontratës me AZHBR-në;
- kosto promovimi për të bërë publik produktin;
- shpenzimet e përgjithshme, si: hartimi i biznesplanit, studime fizibiliteti, patenta, licenca etj.;
- *Lizing Operacional*/financiar për makineri/pajisje;
- aplikuesi, i cili ka dhe menaxhon mbi 25% kapital publik në sipërmarrjen e vet;
- pagesa e TVSH-së;
- faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

MASA 7. Mbështetje për linja/ makineri/ pajisje për përpunimin, paketimin, standardizimin dhe etiketimin e ullirit, vajit të ullirit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave

tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfitues të mundshëm: person fizik ose juridik, i regjistruar në QKB për aktivitetin që aplikon.

a) Të jenë të regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën dorëzohet aplikimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b) Për investimet e përfshira në këtë masë, aplikuesi duhet të jetë i pajisur me licencat e kërkuara nga legjislacioni në fuqi;

c) Të ketë plan-biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin 6 dhe 6/1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

- NPV, duhet të dalë ≥ 0 ;

- IRR duhet të dalë $\geq$ norma e skontimit;

- Norma e skontimit, që do të përdoret për përlllogaritjen e NPV-së, është norma e obligacioneve të thesarit, 2-vjeçare, të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit para hapjes së aplikimeve;

- Në rast të supozimeve të paqarta/të pasakta, AZHBR-ja gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet;

- Në rast se nuk plotësohen këto kriteret ose nuk është plotësuar plan-biznesi standard, aplikimi skualifikohet;

d) Ambienti që do të përdoret për linjat, të jetë në pronësi ose i marrë me qira (për jo më pak se 5 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të subjektit aplikues;

e) Investimi për të cilin aplikuesi është kualifikuar, nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;

f) Mallrat, linjat/pajisjet dhe makineritë duhet të jenë të reja;

g) Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim-taksave për personat fizikë dhe juridikë;

h) Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;



j) Aplikuesi nuk duhet të jenë debitor ndaj AZHBR-së dhe/ose MBZHR-së;

k) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4, 6);

l) Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës.

ii. Kriteret konkurruese:

a) vlera investimit: 60 pikë;

b) plani i biznesit: 20 pikë;

c) aplikant femër: 10 pikë;

d) aplikant me status emigrant: 10 pikë;

TOTALI: 100 pikë.

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera e investimit (max 60 pikë)

- vlera maksimale e investimit: 60 pikë;

- aplikimet me vlera më të vogla në mënyrë proporcionale, sipas formulës:

$X = \text{vlerën e aplikimit} \cdot 60 / \text{vlera maksimale e investimit}$.

Vlerësimi për biznesplanin (Max 20 pikë):

- merr 20 pikë biznesplanin i konceptuar qartë me të gjitha elementet përbërëse.

- aplikimet e tjera vlerësohen me 10 pikë.

Aplikantët femra marrin 10 pikë.

Aplikant me status emigrant 10 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

1. Formulari i aplikimit, sipas aneksit 7.

2. Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit ose pasaportës biometrike të aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor.

3. Fotokopjen e NUIS-it ose NIPT-it, sipas legjislacionit në fuqi për subjektet fizike/juridike.

4. Plan-biznesi i printuar dhe në CD, i detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard të përcaktuar në aneksin 6 dhe 6/1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Tri (3) oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri-tjetrin.

6. Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim-taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e aplikimit.

7. Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë për individin, në rastin e personave fizikë dhe për subjektin në rastin e personave juridikë.

8. Vërtetim nga gjykata/prokuroria për individin, në rastin e personave fizikë, dhe në rastin personave juridikë, vërtetimin në emër të subjektit, që vërteton se aplikanti nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme.

9. Dëshminë e penaltetit për individin në rastin e personave fizikë dhe në rastin personave juridikë dëshminë e secilit ortak të subjektit.

10. Leje apo licenca sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin që mbështeten.

11. Dokumentacioni i pronësisë ose i marrjes me qira të ndërtesës ku do të investohet (qiraja për jo më pak se 5 vjet nga momenti i aplikimit, në emër të subjektit aplikues.

12. Dokumenti i pronësisë së ndërtesës lëshuar nga DVASHT-ja shoqëruar me hartë dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit.

13. Kontratat e qirasë mbi 9 vjet duhet të jenë të regjistruara në DVASHT, sipas ligjit.

14. Për aplikantin me statusin emigrant, fotokopje e noterizuar e certifikatës të rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit.

15. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër, kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit, pasaportës biometrike dhe formulari të regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose, në rast se është në gjuhë të huaj, të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për pagesë

Aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim, sipas formatit të aneksit 8. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:



- faturën/faturat tatimore të blerjes së linjave/mjeteve/pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën e elementeve përbërëse;

- aktzhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementeve përbërëse;

- transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SWIFT-it për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi te shitësi;

- vërtetimin e lëshuar nga zyra e tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- vërtetimin nga AKU dhe inspektoriat shtetëror i mjedisit, që konfirmon se stabilimenti ushqimor përmbush standardet përkatëse për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit;

- vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

MASA 8. Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfitimit

Përfitues të mundshëm janë subjektet me status fizik, juridik, të regjistruar në QKB për aktivitetin që aplikojnë.

a) Investime të pranueshme janë investimet në zona rurale;

b) Të ketë plan-biznesin e detajuar 5-vjeçar, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin 6 dhe 6.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

- NPV, duhet të dalë ≥ 0 ;

- IRR duhet të dalë $\geq$ norma e skontimit;

- Norma e skontimit që do të përdoret për përlogaritjen e NPV-së është norma e obligacioneve të thesarit, 2-vjeçare, të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit para hapjes së aplikimeve;

- Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan-biznesi standard, aplikimi skualifikohet;

c) Punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet duhet të respektojnë karakteristikat, arkitektonike, dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;

d) Aplikimi duhet përmbajë projektet përkatëse, si dhe renderat, preventivin original dhe një përkthim të investimit;

e) Ambienti ku do të kryhet investimi të ketë 6–10 dhoma.

f) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4, 6);

g) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshëm;

h) Aplikanti nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së dhe tatimeve;

j) Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/e rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake duhet të dorëzohet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve.

Investime të pranueshme për këtë masë:

1. Ndërtim/rikonstruksion i ndërtesave në zona rurale dhe/ose i shtëpive të vjetra tradicionale, për sigurimin e akomodimit;

2. Sistemet e kondicionimit, ajrimit dhe ventilimit për ambientet e ofrimit të akomodimit dhe/ose ofrimit të ushqimit;

3. Mobilie dhe pajisje për objektet akomoduese, në funksion të bujtinës, si dollapë, raftë, krevatë, TV dhe pajisje kuzhine;

4. Makineri/pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa, era, dielli dhe gjeotermale për të plotësuar nevojat e energjisë për aktivitetet e zhvillimit të biznesit.

ii. Kriteret konkurruese:

a) kapaciteti maksimal (10 dhoma): 50 pikë;

b) plani i biznesit: 20 pikë;

c) aplikant femër: 10 pikë;

d) aplikant me status emigrant: 10 pikë;

e) investim në 100 fshatrat: 10 pikë.

TOTALI: 100 pikë.

Vlerësimi i aplikimeve:

Kapaciteti maksimal (10 dhoma)

Vlerësimin maksimal e merr aplikimi me kapacitetin maksimal 50 pikë.



Për aplikimet e tjera do të përlogaritet me formulën $X = \text{kapaciteti aktual} \cdot \text{pikët maksimale}(50) / \text{kapacitetin maksimal}$.

Vlerësimi për biznesplanin (max 20 pikë):

- merr 20 pikë biznesplanin i konceptuar qartë me të gjitha elementet përbërëse;
- aplikimet e tjera vlerësohen me 10 pikë.

Aplikantë femër:

Aplikantet femra marrin 10 pikë.

Aplikant me status emigrant: 10 pikë.

Investim në 100 fshatrat: 10 pikë.

Marrin 10 pikë të gjitha investimet që do të kryhen në 100 fshatrat, sipas aneksit 9.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuar nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet në AZHBR:

1. Formulari i aplikimit, sipas aneksit 7;
2. Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit ose e pasaportës biometrike të aplikuesit apo e përfaqësuesit ligjor;
3. Fotokopjen e NUIS-it ose e NIPT-it, sipas legjislacionit në fuqi për subjektet fizike dhe juridike;
4. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së tokës/ndërtesës lëshuar nga DVASHT-ja shoqëruar me hartë dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Ndërtesa/toka që do të përdoret për investimet të jetë në pronësi ose e marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit, në emër të aplikantit/subjektit aplikues. Kontratat mbi 9 vjet duhet të jenë të regjistruara në DVASHT, sipas ligjit;
5. Për aplikantin me statusin emigrant, fotokopje e noterizuar certifikatës së rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;
6. Projektet përkatëse (arkitektonik, konstruktiv, instalimet sanitare, instalimet elektrike, instalimet mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit) dhe relacionet përkatëse (arkitektonik, konstruktiv, instalimet sanitare, instalimet elektrike, instalimet mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit) të firmosur dhe vulosur/firmë digjitale nga arkitekti/inxhinieri përkatës, si dhe preventivin origjinal të firmosur

dhe vulosur/firmë digjitale, nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet nëse është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi;

7. Plan-biznesin e detajuar 5-vjeçar të printuar dhe në CD, sipas modelit standard të aneksit 6 dhe 6.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

8. Përshkrimi i investimit i firmosur nga arkitekti, ku të shpjegohet se punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet respektojnë karakteristikat, arkitektonike dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;

9. Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/e rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake, sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve;

10. Tri (3) oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëri tjetrin;

11. Vërtetimin e lëshuar nga zyra e tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe të kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e aplikimit;

12. Dëshminë e penalitetit për individin, në rastin e personave fizikë dhe në rastin personave juridikë dëshminë e secilit ortak të subjektit;

13. Vërtetim nga gjykata/prokuroria për individin në rastin e personave fizikë, dhe në rastin personave juridikë, vërtetimin në emër të subjektit, që vërteton se aplikanti nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

14. Raporti i kredimarrësisë nga Banka e Shqipërisë për individin në rastin e personave fizikë dhe për subjektin në rastin e personave juridikë;

15. Për aplikantin me statusin emigrant, fotokopje e noterizuar e certifikatës së rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;



16. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose të pasaportës biometrike, formularin e regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose, në rast se është në gjuhë të huaj, të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim, sipas formatit të aneksit 8. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore, shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);

- faturën/faturat tatimore punimeve/pajisjeve, shoqëruar me vlerën ekonomike të elementeve përbërëse etj.;

- aktzhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën të elementeve përbërëse;

- transaksionin bankar dhe/ose SWIFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare, që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti te shitësi;

- vërtetimin e lëshuar nga zyra e tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- certifikatën e klasifikimit të strukturës akomoduese, lëshuar nga autoriteti kompetent, sipas VKM-së 730, datë 20.10.2016, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”;

- vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

MASA 9. Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret specifike të përfutimit

Përfutues të mundshëm: person fizik ose juridik, i regjistruar në QKB për aktivitetin, që aplikojnë.

a) “Investim i pranueshëm” është çdo lloj investimi mikpritës në shërbim të agroturizmit, si veprimtari pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrikulturore, me qëllim për të tërhequr vizitorë, duke u mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtari bujqësore apo veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor;

b) Aplikimi duhet përmbajë projektet përkatëse, si dhe renderat, preventivin original dhe një përshkrim të investimit;

c) Të ketë plan-biznesin e detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin 6 dhe 6/1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili të plotësojë sa më poshtë:

NPV duhet të dalë ≥ 0 ;

IRR duhet të dalë $\geq$ norma e skontimit.

Norma e skontimit që do të përdoret për përlogaritjen e NPV-së është norma e obligacioneve 2-vjeçare të thesarit e pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit, para hapjes së aplikimeve.

-Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR-ja gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.

-Në rast se nuk plotësohen këto kriteret ose nuk është plotësuar plan-biznesi standard, aplikimi skualifikohet;

d) Aplikuesi duhet të ketë përmbushur detyrimet tatimore, lëshuar nga zyra e tatim-taksave për personat fizikë dhe juridikë;

e) Aplikuesi nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

f) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

g) Aplikuesi duhet të sigurojë certifikatën si “Subjekt i certifikuar agroturizmi” në momentin e kërkesës për pagesë;

h) Aplikuesi nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së dhe MBZHR-së.

i) Investimi nuk duhet të fillojë përpara lidhjes së kontratës;



j) Ndërtimet për akomodim të mos jenë më shumë se dy kate dhe me kapacitet akomodues 6–30 dhoma. Rikonstruksionet e objekteve ekzistuese, si kulla ose shtëpi lejohen sipas lartësisë dhe kateve ekzistuese.

k) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4, 6);

l) Ndërtimi duhet të jetë në përputhje me stilin arkitekturor dhe me materiale tradicionale të zonës, në të kundërt, AZHBR-ja gëzon të drejtën për vlerësimin e projektit arkitektonik të dorëzuar duke kërkuar rishikim apo modifikim të projektit fillestar, pa ndryshuar vlerën e investimit;

m) Të gjitha aplikimet, në lidhje me objektet rekreative, sportive, argëtuese, edukative, mikpritëse, makineri dhe pajisje duhet të shoqërohen me plotësimin e sigurimit të akomodimit rural dhe/ose ofrimit të ushqimit.

n) Kostot e projektit arkitekturor dhe konstruktiv janë të pranueshme deri në 2% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 400,000 lekë. Faturat mund të dorëzohen në aplikim ose në kërkesën për pagesë;

o) Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/e rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake duhet të dorëzohet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve.

Aplikimet në lidhje me ndërtimin dhe rikonstruksionin duhet të shoqërohen me një relacion teknik nga arkitekti, duke shpjeguar stilin dhe materialet e propozuara në projekt dhe se si ato përshtaten me zonën përreth dhe investimin.

Llojet e investimeve të pranueshme për këtë masë:

- Ndërtim/rikonstruksion për rinovimin dhe përshtatjen ndaj standardeve të sigurisë/higjienës (sigurimi i tualeteve të përshtatshme) të shtëpive në fermë ose të shtëpive të vjetra tradicionale në fermë, për sigurimin e akomodimit, furnizimin me ushqim, degustimin e ushqimit, pikë shitjeje, muze rural, së bashku me investimet në objekte rekreative.

- Ndërtim/rikonstruksion për zhvillimin e veprimtarive tradicionale të artizanatit, duke përfshirë objektet për paketimin dhe tregtimin e produkteve në fermë, krijimin e punishteve të riparimit apo të artizanatit, përfshirë edhe blerjen e pajisjeve për këto punishte.

- Ndërtim/rikonstruksion për mjedise/vepra me vlerë historike dhe rekreative (si: stenda me vegla të vjetra, mjete pune antike, si: mullinj vaji, dybek etj.).

- Ndërtim/rikonstruksion në zona kodrinore-malore, si: vende kampingu, sporti, pikniku dhe vendqëndrim pushimi, të ndërtuara me gur, dru, kashtë, në funksion të aktivitetit të agroturizmit, përfshirë blerjen e pajisjeve për to.

- Ndërtim/rikonstruksion stane dhe ambienteve ndihmëse/pushimi (si: vend për kamping, stola etj.).

- Ndërtim/rikonstruksion dhe makineri/pajisje për ngritjen dhe modernizimin e stabilimenteve të përpunimit në fermë, duke përfshirë paketimin dhe ruajtjen e produkteve tradicionale të ushqimit, duke përdorur burimet në fermë ose lëndët e para nga prodhuesit vendës.

- Makineri/pajisje për veprimtari sportive, veprimtari çlodhëse dhe argëtuese, si: kulla, mullinj bloje, kampingje, kasolle, kënde lojërash, hipizëm, peshkim sportiv në ujëra të brendshme, shëtitje, rafting, ngjitje në mal, ecje me biçikleta të tipit *mountain bike*, lodra, kopshte zoologjike me kafshë etj.

- Makineri/pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa, era, dielli dhe gjeotermale, për të plotësuar nevojat e energjisë për diversifikimin e fermave dhe aktivitetet e zhvillimit të biznesit.

ii. Kriteret konkurruese:

a) vlera investimit: 30 pikë;

b) lloji investimit (shumëllojshmëri shërbimesh): 40 pikë;

c) numri i vendeve të reja të punës pas investimit: 5 pikë;

d) aplikuese femër: 5 pikë;

e) aplikues me status emigrant: 5 pikë;

f) plani i biznesit: 10 pikë;

g) investim në 100 fshatrat: 5 pikë;

TOTALI: 100 pikë.

Vlerësimi i aplikimeve:

Vlera investimit (max 30 pikë)

- Sipas masës mbështetet vlera maksimale e investimit 30 pikë.

- Aplikimet me vlera më të vogla, në mënyrë proporcionale, sipas formulës:

$X = \text{vlera aplikimit} * 30 / \text{vlera maksimale e investimit}$

Lloji investimit (max 40 pikë)



Investimet e pranueshme pikësohen si më poshtë:

- nëse aplikanti kryen 1 lloj investimi merr 25 pikë;
- nëse aplikanti kryen 2 lloje investimi merr 30 pikë;
- nëse aplikanti kryen 3 dhe/ose më shumë lloje investimesh merr 40 pikë.

Numri i vendeve të reja të punës pas investimit (max 5 pikë)

- Për çdo të punësuar 1 pikë por jo më shumë se 5 pikë në total:

Aplikuese femër (5 pikë)

Aplikues me status emigrant (5 pikë).

Plani-biznesit (max 10 pikë)

- Merr pikët maksimale plani i biznesit, i cili është i konceptuar qartë me të gjitha elementet përbërëse, ku agroturizmi ndërthuret me zhvillimin e produkteve tradicionale të zonës dhe aktivitetet çlodhëse dhe argëtuese që ofrohen.

Investim në 100 fshatrat (max 5 pikë)

- Nëse investimi kryhet në njërin nga 100 fshatrat, sipas aneksit nr. 9, aplikanti merr 5 pikë.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në AZHBR

1. Formulari i aplikimit, sipas aneksit 7;
2. Fotokopje e firmosur e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikuesit apo përfaqësuesit ligjor;
3. Kërkesa për regjistrim “Subjekt i certifikuar agroturizmi”;
4. Fotokopjen e NUIS-it ose të NIPT-it, sipas legjislacionit në fuqi për subjektet fizike dhe juridike;
5. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së tokës/ndërtesës lëshuar nga DVASHT-ja shoqëruar me hartë dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë kalendrike nga data e aplikimit. Ndërtesa/toka që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi ose e marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit, në emër të aplikantit/subjektit aplikues. Kontratat mbi 9 vjet duhet të jenë të regjistruara në DVASHT, sipas ligjit;
6. Plan-biznesin e printuar dhe në CD të detajuar për 5 vjet, sipas modelit standard, të

përcaktuar në anekset 6 dhe 6/1 bashkëngjitur këtij udhëzimi;

7. Projektet përkatëse (arkitektonik, konstruktiv, instalimet sanitare, instalimet elektrike, instalimet mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit) dhe relacionet përkatëse (arkitektonik, konstruktiv, instalimet sanitare, instalimet elektrike, instalimet mekanike, të mbrojtjes ndaj zjarrit) të firmosur dhe të vulosur/firmë digjitale nga arkitekti/inxhinieri përkatës, si dhe preventivin original të firmosur dhe të vulosur/firmë digjitale, nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion, si dhe renderat.

Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet nëse është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi;

8. Përshkrimi i investimit i firmosur nga arkitekti, ku të shpjegohet se punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet duhet të respektojnë karakteristikat, arkitektonike, dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;

9. Për aplikantin me statusin emigrant, fotokopje e certifikatës së rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

10. Dokumenti original ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksionit ose miratimi i deklaratës paraprake, sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës por jo më vonë se 70 ditë kalendrike nga data e përfundimit të aplikimeve;

11. 3 oferta origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikuesin dhe me njëritjetrin;

12. Vërtetimin lëshuar nga zyra e tatim-taksave për personat fizikë dhe juridikë. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më parë se 30 ditë kalendrike nga data e aplikimit;

13. Raporti i kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë për individin në rastin e personave fizikë dhe për subjektin në rastin e personave juridikë;

14. Vërtetim nga gjykata/prokuroria për individin, në rastin e personave fizikë, dhe në rastin e personave juridikë, vërtetimin e në emër të subjektit, që vërteton se aplikanti nuk është në



ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

15. Dëshminë e penalitetit për individin në rastin e personave fizikë dhe, në rastin personave juridikë, dëshminë e secilit ortak të subjektit;

16. Për aplikantin me statusin emigrant, fotokopje e noterizuar të certifikatës së rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

17. Leje apo licenca sipas legjislacionit në fuqi për aktivitetin që mbështeten;

18. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar më sipër, kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose të pasaportës biometrike, QKB-të e ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

iv. Dokumente për kërkesa për financim

Aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim, sipas formatit të aneksit 8. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikuesi paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- certifikatën e regjistrimit “Subjekt i certifikuar agroturizmi”;

- situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstrukcion);

- faturën/faturat tatimore për blerjen e pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse etj.;

- aktzhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementeve përbërëse;

- vërtetimin e lëshuar nga zyra e tatimeve, që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe të kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SWIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi te shitësi;

- vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues.

IX. PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASËN 7–9

1. AZHBR-ja, nëpërmjet zyrës së protokollit, pranon dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit.

2. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masës mbështetëse të firmosur dhe/ose vulosur.

3. Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i dokumenteve pjesore apo përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi (me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit).

4. Mbas plotësimit të dosjes dhe përputhshmërisë së kriterëve, aplikimet vlerësohen me pikë, sipas kriterëve të vlerësimit për çdo masë përkatëse.

5. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Për aplikimet me pikë të barabarta, zbatohet parimi “Kush vjen i pari renditet i pari”.

6. Për aplikimet e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit, bëhet kontrolli paraprak në terren, dhe nëse rezultojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR-ja lidh kontratën përkatëse dhe shpall listën e fituesve.

7. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.

8. Për masën 7, në momentin e kontrollit para pagesës, linjat të jenë të instaluar dhe funksionale.

9. Grupi i kontrollit, në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit, sipas masës përkatëse. Raporti i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Mangësitë skualifikuese, për masën 7–9, janë si më poshtë:

- Aplikimet e dorëzuara pas përfundimit të afatit;



- Mungesa e planit të biznesit në të dyja format, elektronike(CD) dhe i printuar;

- Mospërdorimi i modelit standard të planit të biznesit;

- Mungesa e tri ofertave origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës;

- Ofertuesit janë në konflikt interesi (palë të lidhura) me aplikuesin ose me njëri-tjetrin;

- Paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme (fiktive).

Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë e dokumenteve (që nuk janë pjesë e dokumenteve të renditura më sipër) në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit dhe u lihet një afat 15 ditë kalendarike për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR.

Dorëzimi i dokumenteve pjesore apo përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi, me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit, e cila duhet paraqitet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 70 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve.

Lëvizja e vizës së financimit

Nëse nga “Kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren”, rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR-ja për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës.

Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR-ja njofton aplikantin duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit.

X. PAGESA E VLERËS SË PALIKUIDUAR PËR VITIN 2020

Në zbatim të VKM-së nr. 1102, datë 24.12.2020, pika 5, shkronja “a”, për pagesën e vlerës së palikuiduar për subjektet e shpallur fitues nga AZHBR-ja, në zbatim të vendimit nr. 100, datë 5.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2020”:

Hartohet shtesa e kontratës midis AZHBR-së dhe subjekteve të masës mbështetëse 7, e cila bazohet në Kodin Civil, neni 690, dhe do të shtrijë

efektet e saj si pjesë integrale dhe e pandarë e kontratës bazë. Palët me nënshkrimin e shtesës së kontratës, njohin dhe bien dakord për faktin se ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve thelbësore të kontratës, por duke gjetur të argumentuar dhe të provuar kërkesën e subjekteve kontraktore, përcaktojnë se afati i realizimit të investimit është jo më vonë se data 30.4.2021.

XI. KONTROLLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA

1. AZHBR-ja është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve, sipas masave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.

2. AZHBR-ja gëzon të drejtën për të kërkuar çdo informacion/dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme brenda kriterëve dhe procedurave të miratuara.

3. Për ofertat dhe faturat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e çeljes së thirrjes për aplikim. AZHBR-ja ka të drejtë të bëjë korrigjime aritmetike para kontraktimit, nëse subjektet kanë përdorur kurse të tjera këmbimi. Nëse në ofertë janë përfshirë zëra të listuar në shpenzimet e papranueshme, AZHBR-ka ka të drejtë t'i fshijë para lidhjes së kontratës.

4. Dokumentet e dorëzuara bëhen pronë e AZHBR-së, sipas përcaktimeve nga ligji për ruajtjen e dokumentacionit, dhe nuk i kthehen aplikantit.

5. MBZHR-ja, AZHBR-ja dhe AKSHI hartojnë dhe zbatojnë një plan trajnimi me të gjithë stafin që do të përfshihet në procedurën e aplikimit *online* me 0 dokumente në aplikim.

6. MBZHR-ja dhe AZHBR-ja hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjitha grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

7. Alokimi i fondit sipas masave mbështetëse bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR-së.

8. Në rastet kur numri i aplikuesve të një mase nuk plotëson tavanin e financimit për masën përkatëse, riallokimi i fondeve në masat e tjera bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me propozim të AZHBR-së.



9. Aplikimi, kontrolli administrativ, verifikimi në terren, autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës së aplikimeve përshkruhen në “Manualin e procedurave për implementimin e masave kombëtare”, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së.

10. Formularët/raportet e verifikimit në terren, sipas masave mbështetëse, përgatiten nga AZHBR-ja, në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.

11. Aplikuesit, të cilët skualifikohen gjatë implementimit të masave mbështetëse paraqesin ankesën e tyre brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit pranë AZHBR-së.

AZHBR-ja brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankimesit.

12. Për vlerësime të aplikimeve në masat e investimeve, në rastet ku përfshihen zëra punimesh ndërtimore etj. AZHBR-ja mund të kontrakttojë me kohë të kufizuar ekspertë të licencuar të fushës.

13. Mbështetja financiare llogaritet mbi vlerën e faturës tatimore, përjashtuar vlerën e TVSH-së.

14. Në kontratën që AZHBR-ja do të nënshkruajë me aplikuesin fitues, duhet të përcaktohen qartë penalitetet, në rastet kur përfituesi i fondeve të masave mbështetëse nuk pranon të kontrollohet prej inspektorëve të AZHBR-së.

15. Në momentin e aplikimit, aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.

16. Në rast të konstatimit të “kundërvajtjeve administrative”, nga ana e përfituesit në drejtim të tjetërsimit të qëllimit për të cilën janë marrë fondet

apo mos mbajtjes së dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një periudhë 5-vjeçare, AZHBR-ja propozon sanksione të përcaktuara në nenin 39, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

17. Për menaxhimin e fondeve, AZHBR-ja raporton në mënyrë periodike në MBZHR, e cila raporton çdo katërmujor në MFE për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Milva Ekonomi

MINISTËR I FINANCAVE DHE
EKONOMISË
Anila Denaj

ANEKSET:

Aneksi 1: Lista e agropikave

Aneksi 2: Formulari i regjistrimit të fermës

Aneksi 3: Plan-vendosja e serrës/e tunelit

Aneksi 4: Bimët mjekësore dhe aromatike të regjistruara

Aneksi 5: Formulari për mbjelljen e bimëve mjekësore dhe aromatike

Aneksi 6: Plan-biznesi – pjesa përshkruese

Aneksi 6.1: Plan-biznesi – pjesa financiare

Aneksi 7: Formulari i aplikimit për masat 7–9

Aneksi 8: Kërkesa për pagesë

Aneksi 9: Lista e 100 fshatrave



ANEKSI 1
LISTA E AGROPIKAVE

Qarku	Nr.	
Berat	1	AGROPIKA Berat
Dibër	1	AGROPIKA Dibër
	2	AGROPIKA Mat
Durrës	1	AGROPIKA Rrashbull, Durrës
Elbasan	1	AGROPIKA Elbasan
	2	AGROPIKA Librazhd
Fier	1	AGROPIKA Fier
	2	AGROPIKA Lushnje
Gjirokastrë	1	AGROPIKA Gjirokastrë
	2	AGROPIKA Përmet
Korçë	1	AGROPIKA Pogradec
	2	AGROPIKA Korçë
Kukës	1	AGROPIKA Kukës
Lezhë	1	AGROPIKA Lezhë
Shkodër	1	AGROPIKA Shkodër
	2	AGROPIKA Pukë
Tiranë	1	AGROPIKA Tiranë
	2	AGROPIKA Kavajë
Vlorë	1	AGROPIKA Vlorë
	2	AGROPIKA Sarandë

ANEKSI 2
FORMULARI I REGJISTRIT TË FERMËS

Emri:

Atësia:

Mbiemri:

Datëlindja:

Da

të

M

uaj

Vit

NIPT

Numri personal (me 10 karaktere) nga karta e identitetit

Tel./cel.:

Rr., ndërtesa, hyrja, apartamenti, njësia administrative, bashkia

Fshati:

Njësia administrative

Bashkia

Qarku



Sipërfaqja e tokës së fermës për vitin bujqësor 2021

Nr.	Kategoritë kryesore të tokës	Sipërfaqja në pronësi	Sip. marrë me qira ose forma të tjera përdorimi	Sip. dhënë me qira ose forma të tjera përdorimi	Sipërfaqja e përdorur gjithsej ***
		A	B	C	D = A + B - C
1	Tokë arë gjithsej (1.1+1.2+1.3)				
1.1	- Tokë arë e përdorur (1.1.1+1.1.2+1.1.3+1.1.4+1.1.5+1.1.6)				
1.1.1	- - Drithëra (grurë, misër, thekër, elb, tërshërë etj.)				
1.1.2	- - Perime gjithsej (përfshihen bostanoret)				
	- - - nga e cila në serra				
1.1.3	- - Fasule				
1.1.4	- - Patate				
1.1.5	- - Bimë industriale (luledielli, duhan, sojë, bime medicinale aromatike dhe erëza gatimi, humulus lupulus (maja birrë) etj.)				
1.1.6	- - Foragjere				
1.1.7	Të tjera				
1.2	- Tokë arë e papërdorur vetëm për një vit (djerr/ugar)*				
1.3	- Tokë arë e papërdorur për dy vjet e më shumë				
2	TOTAL: drufrutorë në blloqe (pemë frutore + vresht + ullinj + agrume) (2=2.1+2.2+2.3+2.4+2.5+2.6)				
2.1	- Pemë frutore				
2.2	- Ullishte				
2.3	- Agrume				
2.4	- Vresht				
2.5	Fidanishte				
2.6	Drufrutore të degraduar (e papërdorur)				
3	Kopsht shtëpie**				
4	Livadhe e kullota (vetëm në pronësi)				
4.1	- nga e cila livadhe (vetëm në pronësi)				
5	Pyll (vetëm sipërfaqe pylli në pronësi të fermerit)				
6	Tokë jobujqësore (sipërfaqja e zënë me ndërtesa, si: banesë, stalla, ambiente magazinimi jashtë banesës, rezervuar për kultivimin e peshkut etj.)				
7	Sipërfaqja gjithsej e fermës: 7 = (1+2+3+4+5+6)				

* Tokë arë e papërdorur vetëm për një vit (djerr/ugar) është pjesë e tokës së punueshme (arë) e përfshirë në qarkullim bimor, pa ndonjë qëllim për të prodhuar të korra gjatë viti bujqësor. Karakteristika themelore e tokës djerr është se ajo lihet një vit për qëllime ripërtëritjeje, normalisht gjatë të gjithë vitit bujqësor. Toka djerr mund të jetë: tokë e zhveshur, në përgjithësi pa bimë; tokë me zhvillim të natyrshëm spontan, që mund të përdoret si ushqim për kafshët ose të plugohet; dhe tokë e mbjellë ekskluzivisht për prodhimin e plehut organik të gjelbër.

** Kopsht shtëpie konsiderohet sipërfaqja rrotull banesës, që përdoret kryesisht për kultivimin e produkteve bujqësore, me qëllim vetëkonsumi nga drejtuesi i fermës dhe familja e tij, përgjithësisht është e ndarë nga pjesa tjetër e tokës së punueshme. Sipërfaqe të tilla përdoren kryesisht për prodhimin e perimeve, bishtajoreve të freskëta, patateve, luleve etj. Në kopsht, gjithashtu mund të kultivohen edhe pemë frutore të shpërndara.

***Sipërfaqja gjithsej (ha) që fermeri përdor gjatë vitit bujqësor referues, përfshin sipërfaqen gjithsej në pronësi plus sipërfaqen e marrë me qira minus sipërfaqen e dhënë me qira: Sipërfaqen gjithsej e përdorur = sipërfaqe në pronësi + sipërfaqe marre me qira/sipërfaqe në forma të tjera përdorimi - sipërfaqe e dhënë me qira/forma të tjera përdorimi.

**Blegtoria**

		Kodi	Krerë
1	Gjedhë gjithsej	28	
1.1	- nga këto lopë	29	
2	Të leshta gjithsej	30	
2.1	- nga këto dele qumështi	31	
3	Të dhirta gjithsej	32	
3.1	- nga këto dhi qumështi	33	
4	Derra gjithsej	34	
4.1	- nga këto dosa	35	

Shënim. Periudhë referuese është dita kur merret informacioni.

**Aneksi 3. Planvendosja e serrës/tunelit**

Qarku _____, Bashkia _____

Nj. Administrative _____

PLAN-VENDOSJA E SERRËS/TUNELIT**“Për zëvendësimin e plastmasit në serrat diellore ekzistuese/tunele”**

1. Serra për perime ☐ 2. Serra për rrush tavoline ☐ 3. Tunele për luleshtrydhe ☐

TË DHËNAT KRYESORE**A. Disa të dhëna për serrën/tunelin:**

1. Sipërfaqja e serrës _____, Ha Tunelit _____ Ha
2. Numri kadastral _____
3. Dimensionet: Gjerësia _____ m. Gjatësia _____ m. Lartësia anësore _____ m dhe lartësia në kulm _____ m.
4. Viti i ndërtimit të serrës: _____
5. Viti (i fundit) i ndërrimit të plasmasit _____
6. Tipi i plastmasit ekzistues _____
7. Tipi i ri i plastmasit _____

Aplikanti/Përfaqësuesi: _____

(emër, mbiemër, firmë)

Adresa e aplikanti: _____, Tel./Cel: _____

HARTUESI I PROJEKTIT: Ekstensionisti-AREB/QTTB _____

(emër, mbiemër, firmë)

Adresa _____, Tel./Cel _____



Skica e ngastrës në të cilën është vendosur serra (në formën e gen-planit)

Planimetria e serrës/Skica (vendosja në raport me ngastrën, dimensionet)

Prerje horizontale

APLIKUESI

(Emër, mbiemër, firmë)

Ekstensionisti-AREB/QTTB

(Emër, mbiemër, firmë)

Data _____



ANEKSI 4
BIMËT MJEKËSORE DHE AROMATIKE TË REGJISTRUARA*

(* Në listën e kultivarëve, sipas specieve, përfshihen edhe kultivarë të tjerë të importuar dhe të autorizuar nga ESHFF-ja deri në momentin e aplikimit)

ESHFF	Identifikimi i varietetit	Seleksioneri dhe përgjegjësi	Regjistrimi	Riregjistrimi
00081	Pelin			
00082	Helmarina			
00083	Sinapi i zi			
00084	Kumeli			
00085	Koriandri			
00851	Kokerrmadhi			
00086	Piretrumi			
00861	Lulemesatari i Shkodres			
00087	Izopi			
00089	Manxurana			
00090	Mellaga			
00091	Kamomili			
00092	Bar blete			
00093	Borzilogu			
00094	Mendra			
00941	Borzilogu			
00942	Gjethemesatari			
00943	Gjethemadhi i Napolit			
00944	Gjethvogli per zbukurim			
00945	Gjethvogli per zbukurim			
00946	Xhuxhi perzbukurim			
00947	Engenoli			
00095	Anicia			
00952	Anisum			
00096	Rozmarina			
00961	Angustifolium			
00962	Latifolium			
00097	Shengjini			
00098	Saturea			
00099	Çaji i malit			
00010	Sinapi i bardhe			
00011	Dimerori gjerman			
00012	Longidens			
01231	Xhurmica			
01233	Albanis			
01234	Valeriana			
00013	Aronia Melanocarpia	Llazar Noko	2014	
00014	Makth i Bute(helicrisum Italikum)	Agim Ramaj	2015	
00015	Timus (Thimus Vulgaris)	Agim Ramaj	2016	
00016	Aksi (Helichrisum Italcum)	MEIA Sh.p.k	2016	
00017	Sherbela (Salvia Nord)	Agim Ramaj	2017	
00018	Shafran(Crocus Sativus)	VICTUS FED	2017	
00019	Gentiana Lutea	Agroherbal	2018	
00020	Agulice	Agroherbal	2018	
00021	Bari Bletes (Melisa Officinalis)	Agroherbal	2019	
00022	Lule Shurdhe (Taraxacum Officinalis)	Agroherbal	2019	
00210	Dellenja (Juniperus virginiana L)		1995	
00211	Ekualiptus (Eucalyptus vi minalis L)		1995	
02111	Ekualiptus (Eucalyptus ca mieldule)		1995	
00247	Levande (Levandula augustifolia L)		1995	
00255	Mersine - Mertili(Myrtus Communis L.)		1995	
00163	Dafina (Laurus nobilis)		1995	



ANEKSI 5
FORMULARI PËR MBJELLJEN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE TË
KULTIVUARA

Qarku _____ Bashkia _____

Njësia Administrative _____

FORMULARI

“Për mbjelljen e bimëve mjekësore dhe aromatike të kultivuara,,

Sipërfaqja e mbjellë _____ Ha.

Aplikuesi: _____

Hartuesi i Projektit: Ekstensionisti-AREB/QTTB. _____

Vëndodhja e ngastrës (Nr.pasurisë/kadastral) _____ Sipër ngastrës: _____ Ha

Përshkrimi i teritorit ku ndodhet ngastra:

Përshkrimi i ngastrës:

► Tipi i Tokës _____

► PH(reaksioni i tokës) _____

► Përbërja mekanike e tokës së ngastrës: _____

Bima që do mbillet

► Specia _____

► Një vjeçare ☐

► Shumë vjeçare ☐

Përshkrimi i gjëndjes hidrike të ngastrës:

Masa agronomike

**Masat që do të merren për sistemimin e ngastrës:****Sistemim terreni:**

- sistemim i plotë sipërfaqësor ☐
- sistemim i lehtë sipërfaqësor ☐

Përmirësim hidrik i ngastrës:

- hapje vija kulluese çdo ___ m, ___ cm thellë ☐
- drenazhim i pjesshëm ___ ml, ___ cm thellë ☐
- hapje vija ujitëse çdo ___ m, ___ cm thellë ☐

Punimi i Tokës:

- Plugime të thella ___ cm thellësi,
- Plugim të zakonshme ___ cm thellësi
- Diskim/frezim
- Nivelim sipërfaqësor i ngastrës

Plehrimi i përdorur:

- ___ kv/ha pleh organik
- ___ kv/ha superfosfat,
- ___ kv/ha DAP
- ___ kv/ha K₂SO₄

Disa të dhëna për praktikën e mbjelljes së bimëve:

- Koha e mbjelljes: (muaj, viti) _____
- Distanca e mbjelljes : ___ x ___ cm,
- Numri i bimëve gjithsej/ha: _____

Aplikuesi

(Emri, mbiemri, firma)

Data _____

Hartuesi i projektit (Ekstensionisti /AREB/ QTTB)

(Emri, mbiemri, firma)



ANEKSI 6
PJESA PËRSHKRUESE E PLANIT TË BIZNESIT

<i>1. Historiku i aktivitetit ekzistues</i>	<i>2</i>
<i>1.1. Aktiviteti aktual i aplikantit.....</i>	<i>2</i>
<i>1.2. Struktura e pronësisë</i>	<i>2</i>
<i>1.3. Burimet Njerëzore.....</i>	<i>2</i>
<i>1.4. Performanca e aktivitetit për tre vitet e fundit si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë.....</i>	<i>2</i>
<i>2. Projekti i investimit të ri të propozuar</i>	<i>3</i>
<i>2.1. Paraqitni me një përshkrim të shkurtër dhe një panoramë të përgjithshme të investimit të ri si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin. Duhet të jepni informacione se si mendoni që të jeni të suksesshëm me këtë investim dhe modelin ku ju do të mbështeteni (psh nëse keni një aktivitet në fermë/agrikulturor, si do ta integroni në investimin tuaj, përpunimin/degustim prodhimi, pjesëmarrje në aktivitete në fermë, vjelje, përfitueshmërinë e blerjes të makinerive/pajisjeve në raport me rentabilitetin/cilësinë etj.)</i>	<i>3</i>
<i>3. Detajet financiare të projektit të ri të propozuar</i>	<i>4</i>
<i>3.1. Përmbledhje e kostove dhe financimit</i>	<i>4</i>



1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1. *Aktiviteti aktual i aplikantit*

- *Përshkruani shkurtimisht aktivitetin ekzistues, në lidhje me fermën apo njësinë agrikulturore.*

1.2. *Struktura e pronësisë*

- *Shpjegoni dhe paraqisni një listë të shoqërive që kanë lidhje pronësie me aktivitetin/biznesin tuaj.*

1.3. *Burimet Njerëzore*

- *Numri total i të punësuarve me kohë të plotë si dhe numri i të punësuarve me kohë të pjesshme dhe sezonale.*
- *Numri i të punësuarve mbas investimit (nëse ka).*

1.4. *Performanca e aktivitetit për tre vitet e fundit si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë*

- *Jepni përshkrime të nivelit të performancës financiare të kohëve të fundit.*



2. PROJEKTI I INVESTIMIT TË RI TË PROPOZUAR

- 2.1.** *Paraqitni me një përshkrim të shkurtër dhe një panoramë të përgjithshme të investimit të ri si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin. Duhet të jepni informacione se si mendoni që të jeni të suksesshëm me këtë investim dhe modelin ku ju do të mbështeteni (psh nëse keni një aktivitet në fermë/agrikulturor, si do ta integroni në investimin tuaj, pjesëmarrje në aktivitete në fermë, përfitueshmërinë e blerjes të makinerive/pajisjeve në raport me rendimentin/cilësinë etj.)*
- 2.2.** *Potenciali i Tregut dhe Plani i Marketingut: Përshkruani vendndodhjen e fermës/njesisë agrikulturore tuaj. Përshkruani produktet dhe shërbimet që do të ofroni / përmirësoni, shumëllojshmërinë e tyre, aktivitetet që do të kryhen përmes këtij investimi.*

3. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTIT TË RI TË PROPOZUAR

3.1. *Përmbledhje e kostove dhe financimit*

- Lutemi të paraqisni një përmbledhje të totalit të kostove të investimit të propozuar bazuar në tabelat financiare. Analizoni të dhënat e tabelave financiare NPV dhe IRR dhe se si ato do të ndikojnë në investimin e ri.*



ANEKSI 6.1
MODELI STANDARD I PLANIT TË BIZNESIT

SQARIME

Plani i biznesit plotësohet (pjesa përshkruese dhe tabelat financiare) printohen, firmosen dhe vulosen (n.q.s. ka vulë) nga vetë aplikanti apo përfaqësuesi ligjor.

Dokumentet e printuara janë pjesë e dosjes së aplikimit dhe një kopje elektronike sipas këtyre formularëve tip të plotësuar dorëzohet me CD në dosjen e aplikimit.

Për çdo informacion shtesë, i cili nuk është parashikuar në këto formularë, por gjykohet si i rëndësishëm nga ana juaj, lutemi shtoheni.

Formularët tip të planit të biznesit mund të shkarkohen *online* nga faqja zyrtare e AZHBR-së: **www.azhbr.gov.al**.

Përmbajtja:

[KAPAKU I BIZNESPLANIT](#)

[OFERTAT](#)

[PREVENTIVI](#)

[AMORTIZIMI](#)

[PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE](#)

[PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË](#)

KAPAKU I BIZNESPLANIT**Pasqyrat financiare****APLIKANTI**

INVESTIMI

DATA



APLIKANTI		0														
TABELA E OFERTAVE																
Tabela 1: Kostot e investimit												Shënime/justifikime kur çmimet e zërave në ofertën e përzgjedhur janë më të lartë se dy ofertat e tjera	Oferta 2		Oferta 3	
r.	Llojet e investimit	N jësia	N umri i njësive	Mo nedha	Çmim i për njësi (përfshirë TVSH-në dhe taksa të tjera) (në monedhën origjinale)	Vlera Totale (përfshirë TVSH dhe taksa të tjera) (në monedhën origjinale)	Kur si i këmbimit	Vlera totale (përfshirë TVSH dhe taksa të tjera) (në lek)	TV SH dhe taksa të tjera (në lek)	Vlera totale pa TVSH dhe taksa të tjera (në lek)		Refer encat	Vler a totale me TVSH dhe taksa të tjera (në lek)	Refer encat	Vlera totale me TVSH dhe taksa të tjera (në lek)	
Ndërtime dhe rikonstruksione																
0																
	Totali, ndërtime dhe rikonstruksione							-	-	-		-			-	
Makineri dhe pajisje teknologjike																
0																
	Totali, makineri dhe pajisje							-	-	-		-			-	
V	TOTALI							0	0	0		0			0	

Investimi total	
Shpenzimet e pranueshme	
Granti i kërkuar	0



Tabela e preventivit

0

Për punimet e ndërtimit ose të rikonstruksionit të plotësohet tabela e mëposhtme, sipas preventivit të lëshuar nga inxhinieri.

<i>NR.</i>	<i>Përshkrimi, sipas manualit të ndërtimit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			



APLIKANTI

0

TABELA E AMORTIZIMIT

Amortizimi aktual, vlera (lek për vit)

Tabela 2: Amortizimi i investimit/i aktiveve të reja				
Nr.	Aktivi (emri)	Vlera e aktivit	Numri i viteve	Amortizimi vjetor
I. Ndërtime dhe rikonstruksione				
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
II. Makineri dhe pajisje				
1				
2				
3				
4				
5				
6				
III	TOTALI			0

*Sipas ligjit për amortizimin nr. 8438, të datës 28.12.1998, artikulli 22.

APLIKANTI

PASQYRA E TË ARDHURAVE E SHPENZIMEVE

Sqarime:

EBITDA: Fitimi para interesit, tatimit dhe amortizimit

EBT: Fitimi para tatimit

Tabela 1. Viti normal para investimit (mesatarja e 3 viteve të fundit)						
Kategori	Vlerat vjetore					
	Njësitë	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH	TVSH-ja	Vlera pa TVSH
Të ardhura nga shitjet						
Rezultati total i shitjeve						0
Kostot e prodhimit						

[illegible]

	EBITDA	0
	Amortizimi	0
	EBT	0
	Tatimi mbi fitimin	0
	Fitimi neto	0

Tabela 2. Viti normal i prodhimit pas investimit						
Kategori	Vlerat vjetore				TVSH-ja	Vlera pa TVSH
	Njësitë	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH		
Të ardhura nga shitjet						
Rezultati total i shitjeve				0	0	0
Kostot e prodhimit						
Rezultati total i kostove				0	0	0
					EBITDA	0
					Amortizimi	0
					EBT	0
					Tatimi mbi fitimin	0
Fitimi neto						

Kategori	Vlerat vjetore		
	Vlera me TVSH	TVSH-ja	Vlera pa TVSH
Totali i shitjeve			
Totali i kostove të prodhimit			
<i>EBITDA</i>			
Amortizimi			
EBT			
Tatimi mbi fitimin			
Fitimi neto			0



APLIKANTI	
TABELA – FLUKSI I PARASË	

Tabela 1. Shfrytëzimi i kapacitetit

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
100%	100%	100%	100%	100%

Tabela 2: Fluksi monetar	Faza e ndërtimit					
I. Kostoja e projektit të investimit dhe granti		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Granti	0					
Kostoja e investimit të projektit	0					
II. Impakti i investimit						
Kategoria						
Shitjet						
Kostot totale të prodhimit						
<i>EBITDA</i>						
Amortizimi						
EBT						
Tatimi mbi fitimin						
Fitimi neto						
Fluksi monetar	0					

Norma e interesit

NPV	0 LEK
IRR	#NUM!



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQESOR DHE RURAL

ANEKSI 7

FORMULARI I APLIKIMIT PËR INVESTIME 2021

Informacioni përgjithshëm mbi Aplikantin

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI	
2	KARTA E IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT-i	
6	RREGJISTRIMI NË QKB (DATA)	
7	ADRESA e Aplikantit / QARKU / BASHKI / FSHATI	
8	NUMËR KONTAKTI TEL/CEL	
9	EMAIL	

Të dhëna për investimin:

MASA E INVESTIMIT	
PËRSHKRIMI I SHKURTËR (LLOJI)	
VENDNDODHJA E INVESTIMIT QARKU/BASHKIA/FSHATI	
SHUMA TOTALE E INVESTIMIT	
GRANTI I KËRKUAR	

**MASA E MBËSHTETJES:**

- ☐ **Masa 7.** Mbështetje për linja/makineri/pajisje për përpunimin, paketimin, standartizimin dhe etiketimin e ullirit, vajit të ullirit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
- ☐ **Masa 8.** Mbështetje për ngjitjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë)% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
- ☐ **Masa 9.** Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt.

UNË I NËNSHKRUARI _____ PRANOJ SE, KUR NGA
VERIFIKIMI REZULTON SE PËR MASËN E APLIKUAR NUK JANË
PËRMBUSHUR KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE TË PËRCAKTUARA
NË UDHËZIMIN NR. _____, DT. _____, APLIKIMI SKUALIFIKOHET.

FIRMË

Data _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 8

FORMULARI I KERKESES PER PAGESE 2021

1	EMRI/ATESIA/MBIEMRI ¹	
2	KARTA IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT – i	
6	REGJISTRIMI NË QKR (DATA)	
7	QARKU/RRETHI/BASHKËFSHATI	
8	NUMER KONTAKTI TEL/CEL	
9	VENDNDODHJA E INVESTIMIT	
10	EMRI I BANKËS	
11	LLOGARIA BANKARE NË LEK	
12	IBAN	

MASA E MBËSHTETJES:

- ☐ **Masa 7.** Mbështetje për linja/makineri/pajisje për përpunimin, paketimin, standartizimin dhe etiketimin e ullit, vajit të ullit, bimëve mjekësore e aromatike dhe qumështit në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
- ☐ **Masa 8.** Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 (gjashtë) deri në 10 (dhjetë) dhoma, në 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
- ☐ **Masa 9.** Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt.

Shënim: Ju lutemi përdorni këtë listë për të kontrolluar dokumentat që ju do të paraqisni në varësi të masës.

¹ Emri/Atesia/Mbiemri – të shënohen me gërma kapitale



1. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruktion); ☐
2. Faturën/faturat tatimore të blerjes së pajisjeve/materialeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës; ☐
3. Akt zhdoganimit për pajisjet/materialet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës; ☐
4. Transaksionin bankar dhe/ose SWIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi; ☐
5. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetsore, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë; ☐
6. Vërtetimin nga AKU dhe inspektorati shtetëror i mjedisit, që konfirmon se stabilimenti ushqimor përmbush standardet përkatëse për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit (MASA 7 dhe MASA 9); ☐
7. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare në emër të subjektit aplikues. ☐
8. Certifikatën e regjistrimit “Subjekt i certifikuar agroturizmi” (MASA 9); ☐

Shënim: Ju lutemi të paraqisni listën e të gjitha faturave dhe të llogarisni totalin e parashikuar të shumës së shpenzimeve të pramueshme.

Nr	Përshkrimi i shpenzimit	Sasia	Shuma në Lek me TVSH	Nr. Faturës	Data faturës	Emri furnitorit

Vlera e shumës së kërkuar për pagesë: _____ Lek
(_____)

50% e vlerës së shumës totale të shpenzimeve të pramueshme, por jo më shumë se:

- ☐ MASA 7 - 5 000 000 (pesë milionë) lekë
- ☐ MASA 8 - 5 000 000 (pesë milionë) lekë
- ☐ MASA 9 - 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë

Emri i përfituesit

Nënshkrimi

Data



ANEKSI 7
LISTA E 100 FSHATRAVE

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Fshati
I	Berat	1	Berat	Qafëdardhë
				Roshnik
		2	Ura Vajgurore	Malas Breg
		3	Kuçovë	Kozarë
		4	Skrapar	Blezenckë
II	Dibër	5	Poliçan	Kapinovë
		1	Dibër	Radomirë
				Rabdish
		2	Mat	Bushkash
		3	Bulqizë	Zerqan
III	Durrës	4	Klos	Guri i Bardhë
		1	Durrës	Shetaj
				Radë
				Shënvllash
		2	Shijak	Gjepalaj/Maminas
IV	Elbasan			Metaliaj
		3	Krujë	Halilaj (Zgërdhesh)
		1	Elbasan	Shushicë
				Gjinar
		2	Cërrik	Shtremen
		3	Belsh	Seferan
		4	Gramsh	Sotirë,
		5	Peqin	Pajovë
V	Fier	6	Librazhd	Stëblevë
				Dardhë
		7	Përrenjas	Rrajcë/Skënderbej
		1	Fier	Pojan
				Libofshë
				Cakran
		2	Patos	Siqecë
		3	Roskovec	Luar
VI		4	Lushnjë	Krutje
				Ardenicë
		5	Divjakë	Goricaj
		6	Mallakastër	Hekal
		1	Gjirokastër	Dhoksat
				Zhulat
				Antigonë
				Lazarat
		2	Libohovë	Libohovë e Sipërme
				Nepravishtë
		3	Tepelenë	Nivicë



	Gjirokastrë			Peshtan
		4	Memaliaj	Kalivaç
		5	Përmet	Kosinë
				Leusë
		6	Këlcyrë	Malëshovë
		7	Dropull	Sotirë
VII	Korçë			
		1	Korçë	Drenovë/Boboshticë
				Voskopojë
				Dardhë
		2	Maliq	Zvirinë
		3	Kolonjë	Rehovë
				Borovë
		4	Pogradec	Lin
				Tushemisht
				Gurras
VIII	Kukës	5	Devoll	Arrëz
				Nikolicë
		6	Pustec	Zaroshkë
		1	Kukës	Shtiqën
				Shishtavec
IX	Lezhë	2	Has	Cahan
		3	Tropojë	Valbonë
		1	Lezhë	Fishtë
X	Shkodër			Ishull-Lezhë
		2	Kurbín	Skuraj
		3	Mirditë	Katund i Vjetër
				Orosh
		1	Shkodër	Drisht
XI	Tiranë			Zogaj
				Theth
		2	Vau Dejës	Mjedë
				Kukël
		3	Pukë	Qelëz
		4	Fushë-Arrëz	Kryezi
		5	Malësi e Madhe	Razëm/Vrith
				Lëpushë
		1	Tiranë	Shëngjergj
				Shesh
				Pezë
				Pëllumbas
		2	Kamzë	Laknas
		3	Vorë	Prezë
				Marikaj
		4	Kavajë	Karpen,



		5	Rrogozhinë	Vilë Bashtovë
				German
XII	Vlorë	1	Vlorë	Kaninë
				Tragjas
				Zvërnec
		2	Himarë	Dhërmi/Vuno
				Kuç
				Lukovë
		3	Finiq	Mesopotam
		4	Selenicë	Plloçë/Amantia
				Drashovicë
		5	Sarandë	Çukë
		6	Konispol	Mursi
		7	Delvinë	Rusan

VENDIM**Nr. 5, datë 16.2.2021****NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Elsa Toska	anëtare e “ “

me sekretare Enina Kotoni, në datën 16.2.2021,
mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë
dokumentesh, çështjen nr. 5 (I) Regj. Them., që u
përket:

KËRKUES: Tunxh Vatnikaj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: ZYRA E
PËRMBARIMIT GJYQËSOR PRIVAT
“ALBIUS”;

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës
për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e
mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së
prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, pika 1, 44, 49,
pika 1, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, pika 1,
shkronja “I” dhe 142, pika 3, të Kushtetutës së
Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës
Evropiane për të Drejtat të Njeriut (KEDNJ);
nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000,

“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori
në shqyrtim kërkesën e kërkuarit, për heqjen dorë
nga shqyrtimi i çështjes, pretendimet me shkrim të
kërkuarit, parashtrimet me shkrim të subjekteve të
interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGI*) dhe
Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat “Albius”, si
dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 718, datë 7.5.2012, ka vendosur
deklarimin të pafajshëm të kërkuarit, i akuzuar për
kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”
gjatë kohës që mbante pozicionin e drejtorit të
përgjithshëm të Agjencisë së Kompensimit dhe
Kthimit të Pronave.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.
1280, datë 13.2.2013, ka vendosur lënien në fuqi të
vendimit nr. 718, datë 7.5.2012, të Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Kërkuari në datën 18.2.2013 ka depozituar
pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*në vijim KLD*)
kërkesën për kthimin në pozicionin e gjyqtarit
pranë Gjykatës të Shkallës së Parë Shkodër. Po
sipas kërkuarit, ai i është drejtuar KLD-së edhe në
datën 4.3.2014, me të njëjtin objekt kërkimi, për



kthimin në detyrën e gjyqtarit, kërkesë e cila nuk është marrë parasysh nga KLD-ja.

4. Meqenëse KLD-ja nuk e ka marrë në shqyrtim kërkesën, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur, KLD, për të marrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit në respektim të statusit të paditësit, si dhe detyrimin për të paguar pagën e gjyqtarit nga data 21.2.2009 deri në fillimin e detyrës.”*

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2839, datë 25.5.2015, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, detyrimin e KLD-së të marrë në shqyrtim kërkesën e palës paditëse e depozituar në datën 18.2.2013. Vendimi gjyqësor ribet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit nga përmbartuesi menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë sipas ligjit.”*

6. Mbi ankimin e KLD-së, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 121, datë 28.1.2016, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 2839, datë 25.5.2015, të Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Tiranë”*.

7. Mbi rekursin e KLD-së, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 1057, datë 16.10.2018, ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë kundër vendimit nr. 121, datë 28.1.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit.”*

8. Pasi vendimi ka marrë formë të prerë, kërkuesi në datën 29.2.2016 i është drejtuar zyrës së përmbartimit “Albius” për të filluar procedurat e ekzekutimit të vendimit.

9. Me shkresën nr. 984, datë 29.2.2016, zyra e përmbartimit i është drejtuar debitorit, KLD-së, për ekzekutimin vullnetar të vendimit gjyqësor. Meqenëse nuk është ekzekutuar vullnetarisht vendimi, zyra ka vijuar veprimet përmbartimore duke iu drejtuar përsëri KLD-së me shkresën nr. 1572, datë 24.8.2017, për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor. Nga debitori nuk është kryer asnjë veprim për vënien në ekzekutim të vendimit.

10. Ndërkohë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

11. Me vendimin nr. 4, datë 20.12.2018, të KLGJ-së, është vendosur: *“Deklarimi i krijimit të*

Këshillit të Lartë Gjyqësor në datën 12.12.2018”, bazuar në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

12. KLGJ-ja, në datën 29.12.2019, ka marrë në shqyrtim kërkesën e përmbartuesit gjyqësor për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, dhe pasi ka vlerësuar aktet ka vendosur, me vendimin nr. 243, datë 29.10.2019, refuzimin për kthimin e kërkuetit në funksionin e gjyqtarit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 42, të datës 28.2.2020, ka vendosur: *“Rrëzimin e kërkesëpadisë.”* Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

II

Parashtrimet e palëve

13. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

14. **Subjekti i interesuar, zyra e përmbartimit “Albius”**, ka paraqitur parashtrime me shkrim në datën 21.3.2018, duke argumentuar se kërkuetit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi nuk është ekzekutuar vendimi i formës së prerë brenda një kohe të arsyeshme.

15. **Subjekti i interesuar, KLD-ja**, ka paraqitur parashtrime me shkrim në datën 30.3.2018, duke argumentuar se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe për zvarritjen e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, janë të pabazuara.

16. Ndërsa, KLGJ-ja, me shkresën nr. 234/1 prot., të datës 26.1.2021, duke kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtron se trajtimi i kërkesës së kërkuetit për ekzekutim vendimi të formës së prerë ka qenë në kompetencë të ish-KLD-së për një periudhë 7-mujore, deri më 11 gusht 2016, kur u miratuan ndryshimet kushtetuese. Institucioni i ri, KLGJ-ja, u konstitua më 12.12.2018, ndërsa çështja e kërkuetit u trajtua më 29.10.2019. Koha e trajtimit të kërkesës është e arsyeshme, duke pasur parasysh pamundësinë objektive të organit kompetent pararendës, si dhe kohën e nevojshme në dispozicion të autoriteti të ri të qeverisjes së gjyqësorit për shqyrtimin e saj. Nga ana tjetër,



KL GjJ-ja sqaron se ka vendosur refuzimin e kërkesës me vendimin nr. 243/2019. Kundër këtij vendimi kërkesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 42, të datës 28.2.2020, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesëpadisë*” dhe çështja është rekursuar në Gjykatën e Lartë, po nga kërkesi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

17. Gjykata, në datën 12.2.2021, çeli seancën mbi bazë dokumentesh dhe konstatoi se kërkesi ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, pasi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe çështja nuk është shqyrtuar ende pranë kësaj gjykate.

18. Në nenin 31/b, të ligjit nr. 8577/2000, parashikohet: “1. Kërkesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes. 2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.”. Ndërsa në nenin 43/b, pika 2, të po këtij ligji parashikohet: “Kërkesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa.”.

19. Në kushtet e mësipërme, Gjykata vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitave të sipërcituara.

PËR KËTË ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31/b dhe 43/b, pika 2, si dhe nenin 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.2.2021.

Shpallur më 10.3.2021.

KRYETARE: Vitore Tusha

ANËTAR: Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 6, datë 16.2.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Altin Binaj	anëtar i “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “

me sekretare Enina Mullaj, në datën 16.2.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 2(J)/2018 të Regji. Them., që u përket:

KËRKUES: Jakup Smaili.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. (79) 48, datë 29.1.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. 81, datë 28.3.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2018-240, datë 12.7.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 31, 71, 71/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës në vitin 2016 ka paraqitur përpara gjykatës kërkesën për ekstradimin e shtetasit Jakup Smaili nga Republika e Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë, ku ishte akuzuar për veprën penale “Vrasje e mbetur në tentativë”, ndaj një punonjësi policie, e kryer më 8.6.1984.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (55-2016-1123) 158, datë 14.11.2016, ka vendosur: “*Miratimin e ekstradimit të shtetasit Jakup Smaili, i biri i Sinanit-t dhe i Siblie-s, i dtl. 18.12.1957, lindur dhe banues në Verbiçë-Zhegucite, Komuna Lipjan, Kosovë, me kombësi shqiptare dhe shtetësi kosovare, nga Republika e Shqipërisë për në Republikën Federale të Gjermanisë.*”.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 8, datë 19.1.2017, ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. (55-2016-1123) 158, datë 14.11.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për ekstradimin e shtetasit të kërkuar Jakup Smaili nga Republika e Shqipërisë për në Republikën Federale të Gjermanisë, për nevoja të çështjes penale të filluar nga ana e autoriteteve gjermane të drejtësisë. Shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” të caktuar ndaj shtetasit kosovar Jakup Smaili.*”. Ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë nga asnjë prej palëve ndërgjyqëse.

4. Në datën 25.11.2017 kërkuari është ndaluar përsëri si person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e drejtësisë gjermane për kryerjen e veprës penale në datën 8.6.1984 në Republikën Federale të Gjermanisë.

5. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës edhe në këtë rast, ka paraqitur përpara gjykatës kërkesën për

ekstradimin e shtetasit Jakup Smaili nga Republika e Shqipërisë në Republikën Federale të Gjermanisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. 79 (48), datë 29.1.2018, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kukës. Të miratojë ekstradimin e shtetasit Jakup Smaili, i biri i Sinanit dhe i Siblies, i dtl. 18.12.1957, lindur dhe banues në Verbiçë - Zhegucite, Komuna Lipjan, Kosovë, me kombësi shqiptare dhe shtetësi kosovare, nga Republika e Shqipërisë për në Republikën Federale të Gjermanisë. Mbajtjen në paraburgim të shtetasit Jakup Smaili deri në disponimin e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë për ekstradimin e tij për në Republikën Federale të Gjermanisë.*”.

6. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 81, datë 28.3.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 79 (48), datë 29.1.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Kundër këtij vendimi kërkuari ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2018-240, datë 12.7.2018, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuari.

8. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 12.11.2018 për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Me plotësimin e kuorumit të parashikuar nga neni 31, i ligjit nr. 8577/2000, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 19.12.2019, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh.

9. Në datën 21.1.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka vënë në dijeni Gjykatën Kushtetuese se kërkuari është ekstraduar në Republikën Federale të Gjermanisë, në datën 18.8.2018.

II

Parashtrimet e palëve

10. Kërkuari, me anë të ankimit kushtetues individual, ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke parashtruar se i është cenuar:

10.1 *Standardi i arsyetimit të vendimit*, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është kontradiktë. Në fund të vendimit edhe pse Gjykata e Lartë shprehet se rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), arrin në përfundimin se nuk duhet pranuar.



10.2 *Parimi i sigurisë juridike dhe i gjësë së gjykuar*, sepse për të njëjtën vepër penale gjykatat e juridiksionit të zakonshëm janë shprehur më parë me vendim, duke refuzuar kërkesën për ekstradim.

10.3 *Parimi i aplikimit të ligjit penal më të favorshëm ndaj kërkuarit*, të parashikuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës. Në kohën kur është kryer vepra penale në Republikën Federale të Gjermanisë, në vitin 1984, ligji penal shqiptar nuk e lejonte ekstradimin. Gjithashtu, sipas legjislacionit penal shqiptar, kjo vepër penale është parashikuar.

10.4 Vendimet e gjykatave për pranimin e kërkesës për ekstradim janë dhënë në shkelje të legjislacionit shqiptar dhe në kundërshtim me praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

11.1 Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që kanë shqyrtuar çështjen kanë respektuar parimet kushtetuese dhe dispozitat ligjore të KPP-së.

11.2 Të gjitha gjykatat që e kanë shqyrtuar çështjen e kanë konsideruar kërkesën e prokurorisë për ekstradim si kërkesë që përmban elemente të reja e të pashqyrtuara më parë, prandaj nuk është cenuar parimi i gjësë së gjykuar.

11.3 Dispozita e parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal (KP), për zbatimin e ligjit penal favorizues, është e zbatueshme për të pandehurit që janë në proces hetimi ose gjykimi në Republikën e Shqipërisë për një vepër penale që është në kompetencë të organeve shqiptare të procedimit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

12. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 ajo nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor për funksionimin e saj dhe shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1,

shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe neni 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e neni 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

15. Gjykata vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Për sa i përket *shterimit të mjeteve ligjore*, bazuar në parashikimet e neni 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata konstaton se kërkuari ka kundërshtuar vendimet gjyqësore objekt shqyrtimi, të cilat kanë vendosur miratimin e ekstradimit të tij në shtetin gjerman, duke pretenduar se ato kanë cenuar të drejtën e tij për proces të rregullt ligjor. Kërkuari ka vënë në lëvizje Gjykatën, pasi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, duke shteruar kështu të gjitha mjetet ligjore efektive në dispozicion përpara se të ushtrojë ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk ka mjet tjetër ligjor për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, Gjykata konstaton se kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 12.11.2018 për kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe vendimi i fundit i dhënë për çështjen e tij mban datën 12.7.2018, prandaj kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Sipas neni 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a të ligjit nr.



8577/2000, në lidhje me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*) të ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata thekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

19. Nisur nga ky këndvështrim, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se gjykatat nuk kanë respektuar praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit ka të bëjë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

20. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesit, Gjykata çmon se *prima facie* ato hyjnë në juridiksionin e saj, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe do të shqyrtohen në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

21. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është kontradiktor. Në fund të vendimit, edhe pse Gjykata e Lartë shprehet se rekursi përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së, arrin në përfundimin se nuk duhet pranuar. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i gjësë së gjykuar, si element i parimit të sigurisë juridike, sepse gjykatat e shtetit shqiptar

janë shprehur më parë në lidhje me ekstradimin e tij, duke e refuzuar kërkesën për ekstradim me vendim që ka marrë formë të prerë. Po në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar se nga gjykatat nuk është marrë parasysh aplikimi i ligjit penal më të favorshëm, i sanksionuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës. Sipas tij, në kohën kur është kryer vepra penale, për të cilën akuzohet në Republikën Federale të Gjermanisë, pra në vitin 1984, ligji penal shqiptar, nuk e lejonte ekstradimin. Gjithashtu, referuar legjislacionit penal shqiptar, kjo vepër penale është parashkruar.

22. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm i kanë respektuar parimet kushtetuese. Pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar nuk është i bazuar, pasi të gjitha gjykatat që e kanë shqyrtuar çështjen e kanë konsideruar kërkesën e prokurorisë për ekstradim si kërkesë që përmban elemente të reja e të pashqyrtuara më parë. Gjithashtu, sipas Prokurorisë së Përgjithshme edhe pretendimi tjetër për zbatimin e ligjit penal favorizues, i parashikuar nga neni 3 i KP-së, është i pabazuar, pasi kjo dispozitë është e zbatueshme për të pandehurit që janë në proces hetimi ose gjykimi në Republikën e Shqipërisë për një vepër penale që është në kompetencë të organeve shqiptare të procedimit.

23. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohej individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 67, datë 10.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra



e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 79, datë 14.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata në këtë drejtim ka vlerësuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe çmojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Rekursi është mjeti procedural në dispozicion të kërkuarit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimin nr. 27, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore kushtetuese gjatë procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 27, datë 27.3.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se në shtetin gjerman kërkuar akuzohet për kryerjen e veprës penale “Vrasje e mbetur në tentativë”, e kryer në datën 8.6.1984. Për këtë shkak prokuroria ka kërkuar lejin e ekstradimit të kërkuarit nga shteti shqiptar për në Republikën Federale të Gjermanisë. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkesa e prokurorisë për lejin e ekstradimit të kërkuarit është marrë në shqyrtim dy herë nga gjykatat shqiptare.

27. Fillimisht, në vitin 2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, në vendimin e saj nr. (55-2016-2013), datë 14.11.2016, ka miratuar ekstradimin e kërkuarit, duke u shprehur: “Pretendimi i mbrojtjes për parashkrimin e ndjekjes penale bie poshtë. Ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit penal nuk janë parashkruar sipas legjislacionit të shtetit kërkuar. Neni

211 i Kodit Penal gjerman, sipas shkresës nr. 3117/14 prot I.T., datë 10.11.2016 të Ministrisë së Drejtësisë Tiranë, parashtron se krimi sipas nenit 211 (vrasje) nuk vjetërsobet (parashkruhet).”.

28. Vendimi i lartpërmendur është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 8, datë 19.1.2017, e cila, ndër të tjera, shprehet: “Megjithëse Gjykata e Shkallës së Parë Kukës ka analizuar drejt respektimin e elementëve të tjerë për të kryer ekstradimin drejt Republikës Federale Gjermane të shtetasit kosovar Jakup Smaili, kjo gjykatë nuk ka hetuar dhe dhënë përgjigje ligjore pretendimeve të mbrojtjes për njërin nga elementet e ekstradimit, që është parashkrimi i ndjekjes penale për veprën për të cilën dyshohet se ka kryer i arrestuari... në rastin në shqyrtim ka kaluar afati maksimal 20-vjeçar i parashkrimit të ndjekjes penale, i parashikuar nga legjislacioni penal shqiptar në fuqi.”. Vendimi i gjykatës së apelit ka marrë formë të prerë, sepse nuk është ankimuar.

29. Kërkuar është ndaluar përsëri në vitin 2017, si person i shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet gjyqësore gjermane, për kryerjen e veprës penale në datën 8.6.1984, në Republikën Federale të Gjermanisë. Edhe në këtë rast, prokuroria ka paraqitur kërkesë për ekstradimin e kërkuarit në datën 8.1.2018. Gjatë gjykimit (të dytë) nga ana e përfaqësuesit të kërkuarit është pretenduar se kërkesa nuk mund të merret më në shqyrtim, pasi ajo përbën gjë të gjykuar, duke qenë se ekstradimi i tij është refuzuar më parë nga gjykatat. Gjithashtu, ai ka kërkuar aplikimin e ligjit penal më të favorshëm për kërkuarin, i sanksionuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës.

30. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (79) 48, datë 29.1.2018, ka vlerësuar: “Gjykata çmon se nuk mund të pranohet pretendimi i përfaqësuesit të personit të kërkuar për refuzim ekstradimi, pasi kjo çështje është gjë e gjykuar...në nenin 498/4 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërke të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata.”.

31. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 81, datë 28.3.2018, e vënë në lëvizje në bazë të ankimit të kërkuarit, ka vlerësuar: “Parashikimi i ndjekjes penale parashikohet në nenin 66 të Kodit



Penal, i ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017 dhe sipas kësaj dispozite të ndryshuar është parashikuar se veprat penale të kreut II, seksioni I, nenet 76–79/c, nuk i nënshtrohen parashkrimit. Në këto kushte jemi përballë faktit se vepra penale e vrasjes për të cilën është paraqitur kërkesa për ekstradimin e shtetasit Jakup Smaili nuk i nënshtrohet afatit të parashkrimit nga ligji i shtetit të kërkuar, prandaj me të drejtë ka vlerësuar gjykata se kërkesa për ekstradim është mbështetur në elemente dhe kritere të reja në ligjin penal të ndryshuar dhe që nuk ka qenë në fuqi në kohën e dhënies së vendimit nr. 8, datë 19.1.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër.”

32. Nisur nga këto premisa, Gjykata konstaton se, sipas pikës 2, të nenit 39, të Kushtetutës, ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë dhe vetëm me vendim gjyqësor. Koncepti i institutit të ekstradimit, referuar Konventës Evropiane për Ekstradimin dhe KPP-së, konsiston në një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ka për qëllim dorëzimin e një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një veprë penale.

33. Nga përmbajtja e neneve 5, 39 dhe 116 të Kushtetutës, si dhe nenit 10 të KPP-së, burimet e së drejtës që rregullojnë ekstradimin në legjislacionin shqiptar janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe të ratifikuara, parimet dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të pranuar, si dhe dispozitat e KP-së dhe të KPP-së (*shih vendimin nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këtë këndvështrim, Gjykata vëren se me ligjin nr. 8322, datë 2.4.1998, shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën Evropiane të Ekstradimit (Konventa) dhe dy protokollat shtesë të saj. Sipas nenit 10 të kësaj Konvente “*ekstradimi nuk akordohet nëse parashkrimi i aktit ose i dënimit hyn në fuqi qoftë falë legjislacionit të palës që kërkon, qoftë nga ai i palës së kërkuar*”.

35. Gjithashtu, Gjykata konstaton se në datën 1.6.2014, ka hyrë në fuqi Protokollin i katërt shtesë i Konventës së lartpërmendur, i cili ka ndryshuar nenin 10 të saj, duke parashikuar: “1. *Ekstradimi nuk miratohet kur ndjekja penale ose dënimi*

i personit të kërkuar është parashkruar sipas ligjit të palës kërkuese. 2. Ekstradimi nuk refuzohet për arsye se ndjekja penale ose dënimi i personit të kërkuar do të parashkruhej sipas ligjit të palës së kërkuar.” Shteti shqiptar e ka ratifikuar protokollin në fjalë me ligjin nr. 117/2013, datë 15.4.2013, ndërsa Republika Federale e Gjermanisë e ka nënshkruar më 16.5.2019.

36. Për sa më lart, duke mbajtur në konsideratë se të gjitha vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë marrë përpara datës së nënshkrimit të Protokollit të katërt shtesë nga ana e Republikës Federale të Gjermanisë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret dispozita e aplikueshme është neni 10 i Konventës përpara ndryshimeve, i cili parashikonte ndalimin e ekstradimit kur vepra penale është parashkruar ose nga legjislacioni i shtetit kërkuar, ose nga ai i shtetit të kërkuar.

37. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se në legjislacionin shqiptar vepra penale e “Vrasjes”, për të cilën akuzohet kërkuesi, parashikohet nga neni 76 i KP-së. Përpara ndryshimeve të KP-së të vitit 2017, nuk ndalohej parashkrimi për ndjekjen penale për këtë veprë. Ndërsa duke iu referuar dispozitave aktuale të KP-së (dispozita të ndryshuara me ligjin nr. 36/2017, datë 30.3.2017), në nenin 66, pika 2 të saj, përcaktohet se: “*Veprat penale të kreut II, seksioni I, nenet 76–79/c, nuk i nënshtrohen parashkrimit*.”. Për rrjedhojë, në kohën e shqyrtimit të kërkesës së parë për ekstradim, sipas legjislacionit penal shqiptar në fuqi, ndjekja penale për veprën “Vrasje”, për të cilën akuzohej kërkuesi në shtetin gjerman, ishte parashkruar. Ndërsa, gjatë shqyrtimit të kërkesës së dytë të ekstradimit, sipas legjislacionit shqiptar të ndryshuar, vepra penale “Vrasje” nuk parashkruhet.

38. Sipas KPP-së, në rastet kur një vendim gjyqësor nuk e ka lejuar ekstradimin, kërkesa e re për ekstradim mund të pranohet vetëm në prani të elementeve të reja. Konkretisht, neni 498, pika 4, i KPP-së parashikon: “*Vendimi kundër ekstradimit ndalon dhënien e një vendimi të mëpasshëm në favor të ekstradimit si rezultat i një kërkesë të re të paraqitur për të njëjtat fakte nga i njëjti shtet, përveçse kur kërkesa mbështetet në elemente që nuk kanë qenë vlerësuar nga gjykata*.”.

39. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykata



e Apelit Shkodër, në gjykimin e kërkesës së dytë për ekstradim të kërkuarit, kanë vlerësuar si elemente dhe kritere të reja për ekstradimin e tij dispozitat ligjore, të cilat kanë hyrë në fuqi pas përfundimit të gjyqësorit të parë ku është refuzuar ekstradimi dhe që kanë ndikuar në parashkrimin e veprës penale. Edhe pse dispozitat e reja ligjore kanë natyrë materiale, gjykatat e faktit i kanë zbatuar duke mos arsyetuar pse nuk gjente zbatim parimi i ligjit penal më të favorshëm për kërkuarin, i sanksionuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkesa për ekstradimin e kërkuarit bazohet në të njëjtat fakte dhe prova të vlerësuara më parë nga gjykatat dhe se prokuroria nuk ka paraqitur ndonjë fakt të ri ose nuk ka konstatuar ndonjë element të pavlerësuar më parë nga gjykatat (në gjykimin e parë).

40. Në këto kushte, kërkuari, duke pretenduar se gjykatat e faktit i kanë cenuar parimet themelore të procesit të rregullt ligjor, i është drejtuar Gjykatës së Lartë duke ngritur në rekurs argumente me natyrë kushtetuese. Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e tij, duke mos u shprehur për pretendimet e kërkuarit dhe duke mos u dhënë përgjigje atyre.

41. Gjykata vëren se në përputhje me nenin 39, pika 2, të Kushtetutës, sikurse u përmend më lart, ekstradimi lejohet kur parashikohet shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare dhe vetëm me vendim gjyqësor. Bazuar në këtë dispozitë kushtetuese, Gjykata çmon se togfjalëshi “*vetëm me vendim gjyqësor*”, do të thotë se lejimi i ekstradimit vlerësohet përmes një procesi gjyqësor, i cili në këto raste duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, dhe të materializuara në jurisprudencën kushtetuese, përfshirë edhe standardin e arsyetimit të vendimit.

42. Gjykata thekson faktin se në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kjo e fundit, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 83, datë 26.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më

tepër, me ndryshimet e reja kushtetuese, neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit.

43. Roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për ta kryer vetë këtë rol aktiv, që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Gjykata e Lartë, në bazë të normave procedurale, e ka detyrim ligjor interpretimin e ligjeve, aq më shumë në çështje si kjo që kanë të bëjnë me koncepte të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe zbatimit të konventave, palë e të cilave është edhe Shqipëria (*shih vendimin nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Në këtë kuptim, në rastin konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte për shkaqet me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs nga kërkuari, pra si për pretendimin për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar, të parashikuar nga neni 34 i Kushtetutës, ashtu edhe për pretendimin tjetër të tij, për cenimin e pikës 3, të nenit 29, të Kushtetutës, sipas të cilit ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson të mos ndalet në shqyrtimin e këtyre pretendimeve, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues.

45. Si përfundim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuarit, ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,



VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2018-240, datë 12.7.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.2.2021.

Shpallur më 12.3.2021.

KRYETARE: Vitore Tusha

ANËTAR: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska,
Përparim Kalo, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr. 123 (845), datë 9.2.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Rabije Sali Hoti, e lindur më datë 10.11.1957 në Durrës dhe banuese në Shkodër, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shtetasit Bujar Hamdi Hoti.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë